

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”
ofruar nga Universiteti “Epoka”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Etleva LESKAJ

Dr. Albert GAJO



Shtator / 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Msc në Administrim Biznes

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "EPOKA"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 908, datë 26.08.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 286, datë 06.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Administrim Biznesi
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Angleze
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri aktual i studentëve për këtë program studimi	25

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

[Signature] *[Signature]*

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc. në Administrim Biznesi

Universiteti "Epoka" është një institucion i arsimit të lartë që e ka filluar aktivitetin e tij përgjatë vitit akademik 2007-2008 në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë. Në vitin 2012, bazuar në VKM Nr. 553, datë 22.08.2012, është miratuar ndryshimi i statusit të institucionit privat të arsimit të lartë "Epoka" nga shkollë e lartë në Universiteti privat "Epoka" Me urdhër Nr. 146, datë 31.03.2017 për miratimin e statutit emri i institucionit është Universiteti "EPOKA".

Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është licencuar si Diplomë e Nivelit të Dytë me Vendim të KM Nr. 908, datë 26.08.2009 dhe i është dhënë leja e ushtrimit të veprimtarisë akademike me Urdhër Nr. 248, datë 06.05.2010 po si DND. Bazuar në ligjin e arsimit të lartë nr. 9741, të vitit 2007, ky program është konvertuar në Master i Shkencave po me 120 ECTS dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike. Kjo, konfirmuar edhe në urdhrin nr. 565, datë 22.11.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për regjistrimin e formës së diplomës si dhe me shkresë nr. 3654/4 prot, datë 02.12.2011, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për dërgimin e numrit të identifikimit të diplomave të lëshuara nga ky institucion. Ky program studimi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 286, datë 06.07.2012 në përputhje me Vendim Nr. 339, datë 08.06.2012, të Këshillit të Akreditimit, duke dhënë edhe disa rekomandime për përmirësimin e tij. Konkretisht:

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Dr. Etleva LESKAJ


2. Dr. Albert GAJO

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli

Universiteti Epoka është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.08.2018, përmes sistemit AMS. UE përcjell përmes sistemit më datë 06.08.2018 dhe në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 261/24 Prot, datë 08.08.2018 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me kujdes përgjigjen e UE, paraqiti argumentimin për secilin nga komentet dhe vendosi: të marrë në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ vetëm për komentin 1 (fq. 2 të objeksioneve)

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit në VKA Nr. 339, datë 08.06.2012



- a) Të kryhen studime më të argumentuara shkencore mbi nevojat e tregut të punës në të ardhmen e afërt në Shqipëri
- b) Të dokumentohet më mirë auditimi i jashtëm financiar lidhur me programin MND në Administrim Biznesi.
- c) Të raportohen në mënyrë më të detajuar treguesit e efikasitetit të shfrytëzimit të fondeve, veçanërisht të përfuara nga tarifat e studentëve në programin MND në Administrim Biznesi.
- d) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin: *“Të kryhen studime më të argumentuara shkencore mbi nevojat e tregut të punës në të ardhmen e afërt në Shqipëri”*

GVJ nga vizita në institucion konstatoj se Departamenti i Administrim Biznesit dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative e kanë adresuar çështjen e studimit mbi nevojat e tregut të punës në Shqipëri në bazë të punës individuale të stafit akademik, nëpërmjet projekteve individuale temave të adresuara në artikuj shkencor, tezave të masterit të përgatitura nga ana e studentëve të masterit (**Tabela 1 e Dokumentit të RVB**). Gjithashtu, GVB ka vlerësuar se si bazë për studimin e tregut janë marrë studimet dhe raportet ndërkombëtare për Shqipërinë, si Raporti i vitit 2014 ETF Aftësitë Shqipëria 2020. GVJ gjatë takimeve të punës kërkoi nëse ishte kryer një studim i shënjestruar në mënyrë të drejtpërdrejtë për analizën e nevojave të tregut të punës në Shqipëri. Për sa më sipër, GVJ mendon se **ky rekomandim është plotësuar kryesisht** nga institucioni dhe rekomandon në të ardhmen kryerjen e një studimi të argumentuar dhe shkencor mbi nevojat e tregut të punës, sic është dhënë rekomandimi nga akreditimi i mëparshëm.

- b) Për rekomandimin: *“Të dokumentohet më mirë auditimi i jashtëm financiar lidhur me programin MND në Administrim Biznesi”*.

GVJ nga vizita në institucion siguroi informacion të plote për auditimin e jashtëm të Turgut Ozal sh.a, për gjithë periudhën e akreditimit, informacion ky që është konsultuar nëpërmjet sistemit AMS [**Dokumenti 6.1; 6.2; 6.3; 6.4; 6.5, Vizita ne institucion**]. Në këto raporte paraqitet opinionin i përgjithshëm i audituesit të jashtëm, për kompaninë në tërësi, por nuk paraqitet informacion për programin e studimit Msc. në Administrim Biznesi, që është subjekt i këtij procesi riakreditimi. Gjithashtu nga takimet me drejtues si dhe me GVB, GVJ siguroi informacion edhe për procesin e auditimit të brendshëm që Universiteti Epoka ndërmerr. [**Dokumenti 17. Decision on Internal Audit Team Members and Timetable.pdf, Vizita ne institucion**]. Përsa më sipër GVJ është e mendimit që në lidhje me këte rekomandim të lënë nga akreditimi i mëparshëm, **institucioni e ka permbushur kryesisht atë.**

GVJ sugjeron që institucioni të intensifikojë përpjekjet për të adresuar plotësisht këtë rekomandim të lënë nga akreditimi i mëparshëm

- c) Për rekomandimin: "Të raportohen në mënyrë më të detajuar treguesit e efikasitetit të shfrytëzimit të fondeve, veçanërisht të përfuara nga tarifatat e studentëve në programin MND në Administrim Biznesi".

GVJ konstaton se institucioni ka adresuar plotësimin e këtij rekomandimi dhënë nga akreditimi i mëparshëm. Dosja e vetëvlerësimit përmban të dhëna në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet, jo vetëm në nivel institucional por edhe në nivel programi, duke dhënë të detajuara burimet e të ardhurave, të ardhurat nga tarifatat për dhe gjatë shkollimit si dhe të shpenzimeve edhe për programin e studimeve Msc. në Administrim Biznesi.

Për sa më sipër, GVJ është e mendimit se institucioni e ka përmbushur plotësisht këtë rekomandim

- d) Për rekomandimin: "Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare".

Universiteti Epoka e ka përmbushur plotësisht këtë rekomandim, mbështetur në zbatim e detyrueshëm të Udhëzimit Nr. 14, datë 28.03.2011, LALKSH 80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015, për mbrojtjen e gjuhës së huaj

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit


Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për LAL.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është licencuar si Diplomë e Nivelit të Dytë me Vendim të KM nr. 908, datë 26.08.2009 dhe i është dhënë leja e ushtrimit të veprimtarisë akademike me Urdhër Nr. 248, datë 06.05.2010 po si DND. Bazuar në ligjin e arsimit të lartë nr. 9741, të vitit 2007, ky program është konvertuar në Master i Shkencave po me 120 ECTS dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike. Ky status është konfirmuar edhe në Urdhër Nr. 565, datë 22.11.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për regjistrimin e formës së diplomës si dhe me shkresë nr. 3654/4 prot, datë 02.12.2011, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për dërgimin e numrit të identifikimit të diplomave të lëshuara nga ky institucion. Referuar RVB, strategjisë së departamentit të Administrim Biznesit dhe Planit Strategjik 2013-2017 të institucionit, gjen të specifikuar qëllimet dhe objektivat e institucionit si dhe ato të departamentit të Administrim Biznesit dhe ato të programit Msc. në Administrim Biznesi.

Objektivat e programit të studimit Msc në Administrim Biznesi janë:

- a. Të kenë studentë që fitojnë koncepte profesionale në fushën e administrimit të biznesit dhe t'i përdorin ato në mënyrë efektive
- b. Për të përgatitur studentët në mjedise reale të biznesit në mënyrë që ata të mund të integrojnë modelet e biznesit me praktikatat dhe politikatat reale të botës për të kuptuar mënyrën e funksionimit të proceseve të biznesit.



- c. T'ju mësojnë studentëve metodat e fundit të menaxhimit në mënyrë që ata të mund të ndjekin trendet e fundit në biznes dhe t'i integrojnë këto tendenca në kushte specifike të punës bazuar në njohuritë e fituara në klasë.
- d. Motivimi i studentëve që të kuptojnë strukturën e tregjeve shqiptare dhe të çdo biznesi.
- e. Të ketë studentë që kuptojnë ndërlidhjen e tregjeve të biznesit në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.
- f. Të përgatisë udhëheqësit e ardhshëm të biznesit me trajnime të thella shkencore në fushën e menaxhimit, zhvillimit të burimeve njerëzore, sjelljes organizative dhe kërkimit shkencor.
- g. Përgatitja e sipërmarrësve potencialë që kanë aftësi krijuese për të kontribuar në sektorin e biznesit në vend me ide kreative të biznesit.

GVJ nga shqyrtimi i planit strategjik të departamentit të Administrim Biznesit, konstaton se qëllimet dhe objektivat kryesore për 2017-2022 janë:

- a. Sigurimi i një mjedisi të cilësisë së lartë për mësimdhënie dhe mësim nxënie
- b. Të rekrutojë, edukojë dhe diplomojë studentë me cilësi të lartë në nivelin master
- c. Sigurimi i një mjedisi të cilësisë së lartë për kërkim shkencor [Dokument 19, Arshive]

Referuar planit strategjik 2013-2017, rezulton se Universiteti EPOKA, duke shfrytëzuar përvojën ndërkombëtare, nëpërmjet programeve të saj të diplomimit, traditës së arsimit dhe hulumtimit synon të rrisë shkencëtarët dhe do të përmbushë nevojat e shoqërisë. Universiteti EPOKA, synon të krijojë një Sistem të Njohurive Menaxhuese, në përputhje me parimet e njohura universale. Aktivitetet e Universitetit EPOKA do të fokusohen tek rezultatet, duke synuar përmbushjen e nevojave të industrisë dhe aplikimin e programeve inovative dinamike.


Universiteti synon të organizojë programe edukimi të vazhdueshme për t'iu përgjigjur pritshmërive të tregut, duke qenë në bashkëpunim dhe komunikim me shoqërinë dhe botën e biznesit. Institucioni synon të sigurojë pjesëmarrjen e studentëve nëpërmjet "Këshillit të Studentëve të Universitetit", me qëllim pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve në nivel vendimarrës. [Dokument 5, Arshive]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	GVJ konstaton se PS Msc. në Administrim Biznesi, pranë Universitetit Epoka, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Programi i studimit Master i shkencave në Administrim Biznesi, ka për qëllim t'ju shërbejë studentëve të diplomuar të cilët kanë
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	


¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

<p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>një diplomë bachelor në fushën e Biznesit dhe Ekonomisë ose diplomë universitare të lidhura ngushtë me to, me qëllim forcimin e njohurive dhe të kuptuarit të parimeve dhe praktikave të administrimit të biznesit</p> <p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se PS Msc në Administrim Biznesi, është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. [Dokumenti 4, Arkivë]. GVJ referuar objektivave të PS Msc. në Administrim Biznesi si dhe kurrikulës së tij konstaton se ky PS është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. [Dokumenti 20; 21, Arkive]. Rritja e vazhdueshme e investimeve në vend, si në sektorin publik dhe privat, demonstron nevojën në rritje për të diplomuar me njohuri të thelluara në fushën e Administrimit të Biznesit.</p> <p>Referuar takimeve me GVB, me drejtues të institucionit, GVJ konstaton se PS Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" i ofruar nga Universiteti "Epoka", është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe mbështet interesat strategjike prioritare të zhvillimit të vendit drejt anëtarësimit të plotë në BE, dhe të qënit një vend i zhvilluar perëndimor.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Referuar RVB, dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se ka një vendimarrje nga poshtë-lart ku njësi bazë ka një rol të rëndësishëm për iniciimin e tyre.</p> <p>Referuar planit strategjik të institucionit objektivat strategjike janë:</p> <p>Bashkëpunimi shkencor, edukativ dhe objektivat strategjike të zhvillimit institucional. MSc. në Administrim Biznesi është shqyrtuar dhe dizenuar bazuar tek këto objektiva strategjike. [Dokumenti 5, Arkive]</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit MSc. në Administrim Biznesi është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi funksionon sipas urdhërit të Ministrisë së Arsimit Nr. 248, datë: 06/05/2010. " Lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licencën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit, shkollës së lartë private "Epoka".</p> <p>Programi zbaton kërkesat e akteve rregulatore të</p>



	<p>institucionit, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. [Dokument 8: Statuti i UE, Dokumenti 26 Rregullore Programit, Arkivë]</p> <p>Emërtimi i programit të studimit, është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit sipas nivelit 7 të kesaj kornize, duke theksuar se në këtë program studimi, studentët fitojnë njohuri në menaxhimin e biznesit, si dhe aftësitë organizative për të shërbyer organizatave publike dhe private</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Referuar RVB, vizitës në institucion, dokumentacionit të aksesuar nëpërmjet sistemit AMS, GVJ konstaton se Universiteti Epoka, ka një plan strategjik. [Dokument 5, Arshive]</p> <p>Gjithashtu edhe Departamenti i Administrim Biznesit që është përgjegjës për këtë program studimi, ka një plan strategjik për periudhën 2018-2022, në të cilin objektivat kryesore fokusohen në mësimdhënien, mësim nxënien dhe kërkimin shkencor dhe më konkretisht janë :</p> <ol style="list-style-type: none"> Sigurimi i një mjedisi të cilësisë së lartë për mësimdhënie dhe mësim nxenie Të rekrutoje, edukoje dhe diplomojë studentë me cilësi të lartë në nivelin master Sigurimi i një mjedisi të cilësisë së lartë për kërkim shkencor [Dokument 19, Arshive]
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të arshivuar dhe atij të siguruar gjatë vizitës në institucion, konkludon se:</p> <ol style="list-style-type: none"> Universiteti Epoka ofron programe studimesh të cilat kanë përputhshmëri të lartë me misionin dhe qëllimin e tij dhe se programi Master i shkencave në Administrim Biznesi është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, është organizuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program, Departamenti i Administrim Biznesit, harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. <p>Për sa më sipër GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe janë përmbushur.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)



Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

GVJ në lidhje me termat e përshkrimit mbi termat e referencës së kësaj rubrike i është referuar strukturës organizative të institucionit, përbërjen sasiore dhe cilesore të njësisë bazë dhe strukturave të tjera drejtuese. Referuar strukturës organizative të universitetit, Universiteti “Epoka” përbëhet nga tre fakultete ku secili fakultet përbëhet nga minimumi tre departamente. Bazuar në Urdhërin Nr. 116, datë 13.03.2017 “Hapjen e njësisë kryesore dhe riorganizimin institucional të Universitetit privat “EPOKA”, Universiteti Epoka përbëhet nga këto fakultete:

- a. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i përbërë nga;**
 - Departamenti i Arkitekturës;
 - Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- b. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i përbërë nga;**
 - Departamenti i Financë Bankë;
 - Departamenti i Administrim Biznes;
 - Departamenti i Ekonomiksit;
- c. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale i përbërë nga;**
 - Departamenti i Drejtësisë;
 - Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
 - Qendra për Studime Europiane


Fakulteti është njësia kryesore e Universitetit Epoka, që koordinon zhvillimet arsimore, kërkimore dhe kulturore në fushat e mësimdhënies dhe kërkimit, përkatëse ose që mbulojnë njëra-tjetrën. Fakulteti ofron programe në cikle të ndryshme. GVJ referuar vizitës në institucion dhe të dhënave të siguruara nga RVB, konstatoi se ky fakultet ka në përbërje të tij, një personel akademik të përbërë nga **32** pedagogë, nga të cilët **21** personel akademik efektiv(PAE) dhe **11** personel akademik me kontratë (PAK). **18** anëtarë mbajnë tituj akademik ose grade shkencore. Pra **56 %** e stafit të fakultetit përgjegjës për PS Msc. në Administrim Biznesi, janë me tituj dhe grada. **[Tabela 8, referuar RVB]**

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative përbëhet nga tre Departamente.dhe për vitin akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij **32 personel akademik** konkretisht:

Departamenti i Administrim Biznesit përgjegjës për programin e studimit, ka gjithsej **10** pedagogë nga të cilët **7** janë personel akademik efektiv (PAE), kurse **3** pedagogë janë personel akademik me kontratë (PAK).

Departamenti i Ekonomiksit ka gjithsej **8** pedagogë, nga të cilët **7** janë personel akademik efektiv (PAE) dhe **1** personel akademik me kontratë(PAK).

Departamenti i Financë Bankë ka gjithsej **14** pedagogë, nga të cilët **7** janë personel akademik efektiv (PAE) dhe **7** personel akademik me kontratë(PAK).



Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Autoritet drejtuese akademike të fakultetit janë: Dekani dhe Drejtuesi i njësisë. Autoriteti akademik drejtues është Dekani. Autoriteti administrativ drejtues është Administratori i Fakultetit.

Dekani

Dekani është drejtuesi kryesor i Fakultetit, prezanton Fakultetin si dhe vepron në emër të tij. Dekan i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative është Prof. Asoc. Dr. Salih Özcan

Dekanati

Dekanati i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës që përcakton dhe organizon përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale të Fakultetit, sipas propozimeve të departamenteve. Dekanati përbëhet nga: Dekani, Zv. Dekani, Administratori i njësisë kryesore, Përgjegjësit e Departamenteve ose qendrave të kërkimit shkencor

Këshilli i Profesorëve

Këshilli i Profesorëve është një organ që rregullon dhe vendos për studimet doktorale në Fakultet. Ai përbëhet nga anëtarë me përvojë të gjatë në fushat e tyre dhe vijnë nga Epoka, si dhe nga universitete të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj. Propozimi për kandidatët e ftuar për t'u bërë anëtarë të Këshillit të Profesorëve bëhet nga Dekanati dhe miratohet nga Rektori i Epokës.

Departmenti

Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore. Hapja, bashkimi ose mbyllja e departamenteve tek "Epoka" bëhet me propozim të Senatit Akademik dhe me miratimin e Bordit Administrativ. Programi i studimit Msc në Administrim Biznesi, ofrohet nga Departamenti i Administrimit të Biznesit.

Përgjegjesi i njesise baze


Shefi i Departamentit përfaqëson autoritetin drejtues të njësisë themelore në Universitet. Shefi i departamentit është përgjegjës për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore në çdo nivel të departamentit dhe për drejtimin e rregullt dhe efikas të çdo aktiviteti brenda tij. Shefi i Departamentit të Administrimit të Biznesit Dr. Xhimi Hysa, mban titullin shkencor "PHD" i dhënë nga "Universiteti Sapienza në Romë" në Itali.

Komiteti Shkencor

Komiteti shkencor, përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti Shkencor është përgjegjës për organizimin e programit përkatës të studimeve të nivelit të dytë. Komiteti Shkencor përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimit, programin e kërkimit, kriteret dhe kuotën në të cilën pranohen studentët. Kompetencat dhe funksionet e secilit prej elementeve të strukture organizative të përshkruar më sipër, janë të sanksionuar në statutin e Universitetit Epoka [Dokumenti 8, Arkiva]

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

GVJ analizoi të dhënat për stafin e njësisë bazë, që është përgjegjëse për programin e studimit Msc. në Administrim Biznes, mbështetur mbi të dhënat e siguruara në RVB dhe gjatë vizitës në institucion, gjatë të cilës nuk u vunë re ndryshime në informacione të përcjellë nga RVB.



Në vijim paraqiten të dhënat sasiore dhe cilësore për stafin akademik të departamentit të Administrim Biznesit për vitin akademik 2017-2018. Departamenti i Administrim Biznesit, përbëhet nga 10 anëtarë gjithsej, nga të cilët 7 janë staf akademik efektiv(PAE), prej të cilëve 1 Prof.Asoc, 3 Dr dhe 3 Msc., dhe 3 janë staf akademik me kontratë(PAK), prej të cilëve 1 Dr dhe 2 Msc. [Tabela 8, Tabela 9, RVB].


GVJ gjatë vizitës në institucion nuk konstatoi ndryshime nga të dhënat e referuara në RVB.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

GVJ konstaton se nuk ka ndryshime nga dokumentacioni dhe informacioni i siguruar nga vizita në institucion dhe nga RVB

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Referuar RVB, vizitës në institucion si dhe dokumentave shtesë të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se organizimi i Universitetit Epoka, është në mbështetje të përmbushjes së misionit të tij</p> <p>Referuar strukturës organizative të IAL-së, Universitetit Epoka përbëhet nga tre njësi kryesore: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative si dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative përbëhet nga tre njësi bazë konkretisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Financë Bankë; • Departamenti i Administrim Biznes; • Departamenti i Ekonomiksit; <p>GVJ për sa më sipër është e mendimit, që struktura organizative e institucionit është strukturë efektive dhe i shërben plotësisht të objektivave të programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi. Departamenti i Administrim Biznesit, që mbulon këtë program studimi, ka 7 anëtarë efektivë(PAE), ndër të cilët 1 Prof.Asoc.Dr dhe 3 Dr</p> <p>[Tabela 8. Tabela 9 RVB]</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	



<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>GVJ referuar vizitës në institucion dhe informacionit të siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, konstaton se njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për programin e studimit Msc. në Administrim Biznes kanë të qarta përgjegjësitë që sanksionohen në statut dhe operojnë në mënyrë efektive për ti përmbushur ato.</p> <p>[Dokument 8, 26, 34, Arkive]</p> <p>Referuar RVB, takimit me përfaqesues të zyrës së Burimeve njerëzore dhe me drejtues të njësisë bazë dhe kryesore, të dyja këto njësi luajnë rol primar në rekrutimin e personelit akademik në plotësim të nevojave që ky program master ka.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>GVJ në lidhje me standardet e kësaj fushe vlerësimi, duke u mbështetur në analizen e informacionit të vendosur në dispozicion nga institucioni konkludon se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti Epoka është organizuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij. Struktura organizative e institucionit është strukturë efektive dhe i shërben plotësimi të objektivave të programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi 2. Njësia kryesore dhe bazë e Universitetit Epoka, përgjegjëse për programin e studimit Msc. në Administrim Biznesi, janë të angazhuara drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve dhe përmbushjen e objektivave të tyre 3. Veprimtaritë e tyre janë në përputhje me statutin, rregulloren e institucionit dhe rregulloren e programit master. <p>GVJ në lidhje me këto standarde konkludon se standardet e kësaj fushe janë përmbushur.</p>	


3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

GVJ në lidhje me përshkrimin e situatës për personelin akademik dhe atë mbështetës të programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi, u mbështet në informacionin e plotë që dosja e vetëvlerësimit të këtij programi studimi siguron si dhe në krahasimin e këtij informacioni me atë të siguruar gjatë vizitës në institucion, gjatë të cilës nuk rezultuan ndryshime. Analiza në lidhje me përbërjen sasiore dhe cilësore të stafit është bërë për të gjithë periudhen e akreditimit, 2012-2018.

Departamenti përgjegjës për këtë program studimi është Departamenti i Administrim Biznesit. Përsa i përket Departamentit Administrim Biznesi, për vitin akademik 2017-2018 në përbërje të tij



janë 10 pedagogë nga të cilët, 7 pedagogë, janë personel akademik efektiv(PAE) dhe 3 pedagogë janë personel akademik me kontratë(PAK). Për sa i përket kualifikimit të stafit të departamentit, pra 57% e stafit akademik efektiv dhe 33% e stafit joefektiv janë me tituj/grada. [Tabela 9, referuar RVB]

Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 8 pedagogë gjithsej, të gjithë staf akademik efektiv Personeli administrativ, organizohet në nivel departamenti, dhe departamenti i Administrim Biznesit ka në dispozicion 1 anëtar si staf administrativ. Referuar procedurave të rekrutimit GVJ konstaton se përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre, rregullohet me dispozitat ligjore në fuqi, me dispozitat përkatëse në Statutin e Universitetit Epoka, [Dokumenti 7, 8, 11, arkive].

Referuar takimeve me stafin akademik të përfshirë në program si dhe referuar konsultimit të dokumentit të shpërndarjes së ngarkesës, ngarkesa mësimore të stafit të angazhuar në PS Msc. në Administrim Biznesi është: 9 orë/javë orë për dekanin, 12 orë/javë për shefin e departamentit, 16 orë/javë për stafin e kategorisë profesor dhe doktor i shkencave dhe 20 orë/javë për stafin asistente lektor. [Dokumenti 9 arkiva, Vizita në institucion]

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Referuar Tabelës 13 të RVB, për vitin akademik 2017-2018, në PS Msc. në Administrim Biznesi, janë të angazhuar 8 pedagogë gjithsej, të gjithë pedagogë efektiv 100% staf efektiv i UE. Staf i efektiv i angazhuar, përbëhet nga 3 pedagogë të kategorisë Profesorë, 5 anëtarë me gradën Doktor.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit

Këshilli shkencor i PS Msc. në Administrim Biznesi, përbëhet nga 6 anëtarë, ndër të cilët 2 të kategorisë profesor dhe 3 mbajnë gradën doktor. [Tabela 10, RVB]

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre


Institucioni ka paraqitur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm tabelat me stafin e angazhuar në programin e studimit, që nga viti akademik 2012-2013, konkretisht:

Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 8 pedagogë gjithsej, të gjithë staf akademik efektiv. Pra 100% e stafit të angazhuar në këtë program studimi është staf efektiv me tituj dhe grada. [Tabela 11, RVB]

Për vitin akademik 2016-2017 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë 8 pedagogë gjithsej, nga të cilët 5 kanë qenë PAE, 3 me tituj/grada dhe 3 PAK, 1 me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është 63%/37%. Pra 75% e stafit akademik, mbajnë grade shkencore ose tituj akademik. [Tabela 42, RVB]

Për vitin akademik 2015-2016 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë 7 pedagogë gjithsej, nga të cilët 4 kanë qenë PAE, 4 me tituj/grada dhe 3 PAK, 0 me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është 57%/43%. Pra 57% e stafit akademik, mbajnë grade shkencore ose tituj akademik. [Tabela 36, RVB]

Për vitin akademik 2014-2015 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë 10 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 kanë qenë PAE, 5 me tituj/grada dhe 3 PAK, 1 me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është 70%/30%. Pra 60% e stafit akademik, mbajnë grade shkencore ose tituj akademik. [Tabela 30, RVB]



Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **4** pedagogë gjithsej, **100%** kanë qenë staf efektiv, ndër te cilët janë **75%** janë me tituj dhe grada. **[Tabela 24, RVB]**

Për vitin akademik **2012-2013**, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **3** pedagogë gjithsej, **100%** kanë qenë staf efektiv me tituj ose gradë. **[Tabela 18, RVB]**

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program per vitin akademik aktual është **8/25**

Raporti Personel Administrativ / Student në këtë program per vitin akademik aktual është **1/25**.

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik aktual është **8/0**

Përsa më sipër GVJ konstaton se për një periudhë 6 vjecare, stafi i angazhuar në këtë program ka pësuar rritje. Vihet re një rritje konsistente e stafit akademik efektiv të angazhuar në PS Msc. në Administrim Biznesi. Në lidhje me kualifikimin e stafit, stafi me tituj dhe grada për intervalin kohor 2012-2017, është **57% -100%**.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Referuar të dhënave për përbërjen moshore të stafit akademik, rezulton se **100 %** e stafit efektiv janë nën moshën **55** vjec për vitin akademik **2017-2018**. GVJ nuk konstatoi ndryshime nga të dhënat e deklaruara në RVB dhe atyre të siguruara gjatë vizitës në institucion për përbërjen e stafit.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

GVJ referuar dokumentacionit të arshivuar nga institucioni, informacionit të siguruar nga shqyrtimi i dosjeve të stafit, konstaton se punonjësit akademik te Universitetit Epoka, punësohen me kontrata me afate të pacaktuara ose të caktuara. Kontrata e punës përmban identitetin e palëve, vendin e punës, përshkrimin e përgjithshëm të punës, detyrimet dhe te drejtat e paleve, kohëzgjatjen e kontratës, kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës, elementet përbërëse të pagës, kohën normale javore të punës. **[Dokumenti 10. Model Kontrate pune, Arkiva]**

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi administrativ, kryesisht është në nivel institucioni por referuar strukturës organizative të institucionit, **1** anëtar i stafit administrativ është në nivel departamenti, duke qenë i angazhuar plotësisht në përbushjen e kërkesave që njësi bazë dhe programi i studimit ka.


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me stafin e programit të studimit por edhe me studentët e këtij PS, vlerëson se stafi akademik, ndihmës mësimdhënës shkencor dhe administrativ angazhohet për të përbushur objektivat e programit të studimit dhe për t'i arritur ato.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Kjo vërtetohet nga kualifikimet dhe programet e pajtueshmërisë ku ata janë të angazhuar.


	<p>Stafi akademik, ndihmës mesimor-shkencor dhe administrativ angazhohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit Epoka. Personeli perzgjodhet duke treguar një rëndësi të veçantë në fushën e specializimit, e cila është në përputhje me strategjitë zhvillimore të institucionit.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar RVB, takimeve me drejtues të njësisë bazë dhe me stafin e programit, personeli akademik angazhohet në nivel departamenti për diskutimin dhe përmirësimin e syllabuseve të lëndëve dhe raporteve të lëndëve në programet e departamentit. Rishikimi dhe përmirësimi i hartimit të kurrikulës bëhet nga departamenti, dhe ndryshimet e sugjeruara i përcillen Dekanatit; miratimin përfundimtar e jep Senati me Vendim, me mbështetjen e Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Sigurimit të Cilësisë të Universitetit "Epoka"</p> <p>Referuar takimeve me stafin akademik të përfshirë në program si dhe referuar konsultimit të dokumentit të shpërndarjes së ngarkesës, ngarkesa mësimore të stafit të angazhuar në PS Msc. në Administrim Biznesi është 9 orë/javë për dekanin, 12 ore/jave për shefin e departamentit, 16 ore/jave për stafin e kategorise profesor dhe doktor i shkencave dhe 20 ore/jave për stafin asistent-lektor.</p> <p>[Dokument 9 arkiva, Vizita ne institucion]</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me drejtues të njësisë bazë dhe kryesore si dhe me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore, rezulton se Universiteti Epoka, ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren dhe të orientuar drejt rekrutimit të stafit me ekperiencë dhe me fuqi ekspertize të lartë. [Dokument 8, 11, Arkive]</p> <p>Referuar takimeve me drejtues të institucionit, me stafin akademik të përfshirë në këtë PS, dhe nga informacioni i siguruar nga dosja e vetvlerësimit, rezulton se për vitet akademike 2017-2018; 2012-2013; dhe 2013-2014, 100% e ngarkesës është mbuluar nga stafi efektiv i Universitetit Epoka.</p> <p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dosjes se vetvlerësimit dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion në takimet me GVB, përfaqësues të NJSBC dhe drejtuesin e njësisë bazë, se Universiteti Epoka ndjek procedura të</p>



	<p>vlerësimit të personelit transparente dhe ligjore [Dokumenti 42, 18, 17]. Kryerja e anketave për vlerësimin e stafit akademik nga ana e studentëve bëhet çdo semester para se studentët të kenë informacion për vlerësimin final të lëndës dhe rezultatet bëhen publike mbas marrjes së vlerësimit final. [Takimi me stafin, me drejtues dhe me zyren e IT-se]</p> <p>Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me përfaqësuesen e zyrës së burimeve njerëzore konstatuam se Universiteti Epoka mban të dhëna të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, por GVJ nuk konstatoi një bazë të dhënash pranë kësaj zyre dhe nuk inspektoi procedurë të rekrutimit të stafit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që procedurat e rekrutimit të stafit si dhe baza e të dhënave e raporteve të rekrutimit të stafit, të depozitohen pranë zyrës së burimeve njerëzore.</i></p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Referuar RVB përgjegjësi i programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi ka gradën shkencore “PHD” të fituar pranë universitetit “La Sapienza”, Rome, Itali dhe me përvojë të gjatë akademike.</p> <p>Referuar <i>Tabela 68 RVB</i> dhe takimeve me stafin akademik të programit, rezultoi se 100% e stafit të angazhuar në këtë program studimi mban gradën “Doktor i shkencave”.</p> <p>Referuar informacionit të siguruar nga dosja e vetëvlerësimit, vihet re se ka anëtar të stafit akademik që mbulojnë deri në 7 lëndë në këtë program studimi dhe gjithashtu mbajnë detyra funksionale në strukturën organizative të Universitetit Epoka. Këto lëndë përmbledhin një spektër të gjerë dhe të diversifikuar disiplinash.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të ulet numri i lëndëve që mbulon stafi dhe të ketë përputhshmëri më të lartë mes fushës së ekspertizës së stafit dhe lëndëve që mbulojnë.</i></p> <p>Referuar strukturës organizative dhe kontratave të punës konsultuar gjatë vizitës në institucion, rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, përgjegjësi i departamentit, të Administrim Biznesit që është përgjegjës për këtë program studimi, janë të punësuar me kohë të plotë në Universitetin Epoka.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i planit mesimor, konstaton se studentet që ndjekin këtë program studimi nuk kanë detyrim në realizimin e praktikës profesionale, pasi ajo nuk është pjesë e kurrikulës, por pavarësisht kësaj GVJ konstatoi nga</p>



	<p>takimet me studentë të këtij PS, se ata paraqesin interes dhe ndjekin praktika opsionale në kompani të ndryshme si rezultat i bashkëpunimit të tyre me Universitetin Epoka.</p> <p>[Dokumentit 8. List of internships in Business Administration.pdf, vizita ne institucion]</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Referuar rregullores së programit master por edhe takimeve me drejtues të njësisë bazë e stafin e programit, koordinatori i programit përkatës i propozon Këshillit të Fakultetit një mbikëqyrës të tezës për secilin student në fund të semestrit të tretë dhe temën e tezës së miratuar nga mbikëqyrësi i tezës jo më vonë se fundi i semestrit të tretë.</p> <p>[Dokumentit 8, Arkive; Dokumentit 8. List of internships in Business Administration.pdf, vizita ne institucion]</p> <p>Sipas rregullores së Universitetit Epoka në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe dokumentit 8. List of internships in Business Administration.pdf, të siguruar nga vizita në institucion, mbikëqyrësit e zgjedhur nga stafi akademik kanë të paktën gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Referuar shpërndarjes së temave të diplomës për vitin 2017-2018, rezulton se mbikëqyrësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 studentë në të njëjtën kohë. Mbikëqyrësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimit dhe në të cilin zhvillohet teza. [Dokumentit 8. List of internships in Business Administration.pdf; Dokumenti 2-11, vizita ne institucion]</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Referuar shpërndarjes dhe titujve të temave për vitin akademik 2017-2018 dhe të CV të stafit, të siguruar nga vizita në institucion dhe të konsultuar nëpërmjet sistemit AMS, rezulton se fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit</p> <p>[Dokumentit 8. List of internships in Business Administration.pdf; Dokumenti 2-11, vizita ne institucion]</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	



<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ vlereson se Universiteti Epoka dëshmon një angazhim optimal të personelit mësimor-kërkimor për realizimin e klasave laboratorike, kur modulet përkatëse kërkojnë përdorimin e objekteve laboratorike që janë të vendosura në mjediset e universitetit.</p> <p>Universiteti Epoka dëshmon se ka një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë, e cila u demonstrua nga stafi administrativ dhe ndihmës mësimor-shkencor edhe gjatë vizitave në institucion dhe u mbështet edhe nga takimet me studentet që ndjekin këtë PS.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>GVJ referuar takimeve me stafin akademik të përfshirë në program si dhe kontratave të punës dhe dokumentit të shpërndarjes së ngarkesës, të siguruara gjatë vizitës në institucion, rezulton se personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Referuar dokumentave që GVJ konsultoi për këtë program studimi, rezultoi se kjo ngarkesë vlerësohet me orë mësimore. Ngarkesa e stafit referuar shpërndarjes së ngarkesës së stafit të programit është në intervalin nga 13-20 orë mësimore në javë</p> <p>[Dokumenti 9. Teaching & Supervision Load of the academic staff.pdf, Vizita ne institucion; Dokumenti 9 arkiva].</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Referuar infomacionit të dosjes së vetëvlerësimit dhe atij të siguruar nga vizita inspektuese në institucion rezulton se Universiteti Epoka për programin e studimit Msc. në Administrim Biznesi, ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program [Tabelat 18, 24, 36, 42, 48]</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ siguroi listën e plotë të stafit akademik të angazhuar në cdo semestër në këtë program studimi për 2017-2018 [9. Teaching & Supervision Load of the academic staff.pdf, Vizita ne institucion]</p> <p>Universiteti Epoka publikon kriteret për punësim në web sitin zyrtar. Kriteret e shpallura janë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe me Rregulloren e Punësimit dhe Vlerësimit të Performancës Akademike, gjithashtu dhe duhet të ketë gradën shkencore "Doktor"</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ nga analizimi i të dhënave sasiore dhe cilësore të stafit të angazhuar në programin e studimit Msc. në Administrim Biznesi, të ngarkesës mësimore vlerëson:

1. Personeli akademik i programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi, angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.
2. Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.
3. Procedurat për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit të programit të studimit Msc në Administrim Biznesi, janë ligjore, transparente në funksion të rekrutimit të një stafi akademik të përgatitur dhe me eksperiencë ndërkombëtare në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
4. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.
5. Departamenti i Administrim Biznesit pranë Universitetit Epoka, në varësi të nevojës parashtron edhe kriteret për rekrutimet e reja, që janë në varësi të lëndës për të cilën ka lindur nevoja. Procedura e rekrutimit kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rregulloren dhe statutin e institucionit. Njoftimet për vende vakante bëhen në faqen zyrtare të institucionit
6. Duke qenë se konstatohet një numër i lartë lëndësh për safin akademik që shkon deri në 7 lëndë brenda të njëjtimit program studimi, *GVJ sugjeron që:*

Universiteti Epoka, të vlerësojë mundësinë e uljes së numrit të lëndëve që mbulon çdo pedagog, apo rritjen e numrit të stafit të përfshirë në këtë program, për të krijuar një përdorim optimal të burimeve njerëzore, por edhe për të krijuar një ekuilibër mes objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve administrative që anëtarët e këtij stafi mbulojnë.

Gjithashtu GVJ sugjeron që procedurat e rekrutimit të stafit si baza e të dhënave e raporteve të rekrutimit të stafit, të depozitohen pranë zyrës së burimeve njerëzore.

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur kryesisht

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti Epoka është i vendosur në autostradën Tiranë-Rinas në një zonë të gjelberuar dhe larg zonës urbane. Kampusi qëndror shtrihet në një sipërfaqe totale prej 67.000 m². Në Kampusin e Universitetit Epoka përdoren për zhvillimin e mësimin 17 klasa, 3 laboratore kompjuterash. Godina është e pajisur me 3 salla interneti. Universiteti ofron internet 24 orë në të gjithë hapësirën e tij. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton dhe vlerëson infrastrukturën moderne të kampusit, për të qenë në mbështetje të plotë të programeve të studimit që institucioni ofron. Auditoret rezultojnë të pajisur me videoprojektorë, me PC, me tabela inteligjente, me sistem qëndror ngrohje-ftohje, të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor.



Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me përfaqësues të ZKTIK, për GVJ u demonstruan shërbimet kryesore që kjo zyrë ofron, të cilat parqiten si shërbime të integruara dhe që ndikojnë në rritjen e efektivitetit të funksioneve të njësive të tjera dhe të gjithë institucionit si dhe në sigurimin e një informacioni strategjik për të rritur efektivitetin në vendimmarrje nga ana e institucionit dhe njësive përbërëse të tij.

GVJ konstatoi se shërbimet që ofron kjo zyrë fokusohen në përdorimin e programeve Turnitin, si një soft që vjen në ndihmë për shmangien e plagjaturës por edhe në ndihmë të citimit të burimeve shkencore dhe akademike. Pjesë e demonstrimit të sistemeve të informacionit për GVJ gjatë vizitës në institucion ishte edhe sistemi LMS, i cili sic u demonstrua, ishte një sistem që iu vjen në ndihmë stafit akademik dhe studentëve me qëllim aksesin, koordinimin dhe organizimin në internet të materialeve të lëndëve Biblioteka manaxhohej nepermjet sistemit informatik Koha që përdoret si burim i hapur nga qindra bibliotekë në mbarë botën. Stafit akademik, administrativ dhe studentet e programit pajisen me ëeb mail nepermjet domenit epoka.edu.al që është llogari ne google dhe që lejon komunikimin zyrtar mes këtyre përdoruesve. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se kur këta studentë mbarojnë programin e studimeve Msc. në Administrim Biznes, ata pajisen me një adrese emaili që i klasifikon ata tashmë si pjesë e rrjetit Alumni. GVJ nga komunikimi me stafin e zyrës së IT në Universitetin Epoka konstatoi edhe shërbime të tilla si Google Classroom që ndihmon në koordinimin dhe organizimin e leksioneve dhe materialeve të tjera të disiplinave në cloud. GVJ konstatoi se informacioni në lidhje me programet, kurrikulën dhe silabusin e lëndës ofrohen nëpërmjet faqes së internetit Sistemi Informatik të Edukimit duke dhënë informacion për përdoruesit.

Biblioteka

Biblioteka ka një kapacitet prej 100 vendesh, përbëhet nga hyrja, salla e librave dhe e leximit. Universiteti "EPOKA" është anëtare e Unionit të Bibliotekave të Ballkanit. Koleksioni i bibliotekës është pasuruar nga blerjet dhe donacionet. Çdo vit, secili Departament plotëson një formular me specifikë për librat që i nevojiten dhe ia dërgon Rektoratit për miratim. Biblioteka ka një total prej 7,500 librash të shtypur. Databaza Dixhitale Universiteti "EPOKA" është anëtare me të drejta të plota në JSTOR, dhe përmban më shumë se 2,000 revista akademike. Çdo anëtar i personelit të Epokës mund të ketë akses në koleksionet JSTOR duke klikuar tek <http://ëëë.jstor.org/> dhe kërkon apo shfleton për përmbajtje. Biblioteka gjendet në katin e parë të godinës A në kampusin e Rinasit dhe është ngritur për të mbështetur aktivitetet arsimore dhe kërkimore të universitetit, duke ofruar dhe organizuar dokumentet e kërkua.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset e Universitetit Epoka, referuar informacionit të marrë nga dosja e vetëvlerësimit dhe nga vizita në institucion rezutojnë si mëposhtë:

- | | |
|--|----|
| • Salla për leksione | 5 |
| • Klasa për seminare | 17 |
| • Salla për aktivitete promovuese | 1 |
| • Salla për praktikë lëndore/ profesionale | 2 |

- Laboratorë për lëndët 3
- Laboratorë informatike 2
- Salla interneti 2
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1
- Zyrë informacioni për studentët 2
- Nyje hidrosanitare 89

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 5
- Zyra për sekretarinë mësimore 2
- Zyra për departamentet 12
- Zyra për personelin akademik 40
- Zyre per NJSBC 1

Të dhënat e mësipërme i referohen shqyrtimit të dosjes së vetëvlerësimit si dhe vizitës në institucion .

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Ne lidhje me kete fushe vleresimi, nuk iu kerkua institucionit dokumentacion shtese.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave</p>	<p>Universiteti Epoka është i vendosur në autostradën Tiranë-Rinas në km e 12-të. Kampusi qëndror i Universitetit shtrihet në një sipërfaqe totale prej 67.000 m², duke shërbyer si vendodhje e përhershme. [Dokumenti 12, Planimetria, Arkive]</p> <p>Universiteti "EPOKA" e përmbush këtë kriter sepse ambientet e tij nuk janë objekt i qiramarrjes. Për GVJ rezulton se Universiteti "EPOKA" është pronar i mjediseve që përdoren për veprimtaritë e Universitetit. Kjo pronësi, mendojmë se krijon stabilitet më afatgjatë nga pikëpamja infrastrukturale, për zhvillimin e programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi</p> <p>GVJ referuar vizitës në institucion si dhe të dhënave infrastrukturale në RVB, konstaton se Universiteti "EPOKA" ka kapacitete manaxheriale të mjaftueshme për të garantuar menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm</p>

teknike, etj.	<p>për arritjen e standardeve të duhura të cilësisë si dhe për plotësimin e objektivave për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi.</p> <p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi pasi në kurrikulën e tij nuk parashikohen praktika profesionale.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ referuar edhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se Universiteti Epoka dhe çdo pedagog, siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme</p> <p>GVJ, konstaton nga informacioni, i marrë gjatë vizitës në institucion, se biblioteka e Universitetit Epoka, ka literaturë të mjaftueshme, gjë e cila e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit dhe për përgatitjen e tezës</p> <p>Në bibliotekën e Universitetit Epoka, gjenden botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme, për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës. Universiteti "EPOKA" është anëtare me të drejta të plota në JSTOR, dhe përmban më shumë se 2,000 revista akademike. Çdo anëtar i personelit të Epokës mund të ketë akses në koleksionet JSTOR.</p> <p>Sipas RVB, përgjegjësit e programeve dhe pedagogët, janë të angazhuar për pajisjen e bibliotekës me tekstet mësimore dhe literaturës së fundit. GVJ konstatoi kërkesa të departamentit për blerje literature, shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët</p> <p>[Dokument 3. Enriching of Library Resources.pdf, Vizita në institucion]</p> <p>Referuar RVB, por edhe informacionit të siguruar nga studentët dhe nga personeli i bibliotekës gjatë vizitës në institucion, rezulton se orari i bibliotekës afishohet në mjediset e institucionit, por edhe në hyrje të bibliotekës dhe është e hapur për studentët: E hënë – E premte: Ora 08:30 - 12:30 Ora 13:30 - 19:30 E shtunë: Ora 09:00 - 13:00</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e</p>	<p>GVJ referuar dosjes së vetëvlerësimit por edhe vizitës në ambientet e Universitetit Epoka është e mendimit se institucioni ka sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të</p>


<p>programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>teknologjisë së informacionit, për realizimin e PS Msc. në Administrim Biznesi</p> <p>Referuar vizitës në institucion, inspektimit të auditorëve dhe ambienteve të mësimdhënies, ato rezultojnë të pajisura me teknologjinë e duhur të infomacionit në shërbim të proceseve efektive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me PC, videoprojektore dhe smart board dhe kushte ergonomike.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe nga dosja e vetëvlerësimit, GVJ konstaton se Universiteti Epoka posedon një laborator kompjuteri të përbërë nga 41 kompjutera, dhe me video projektor, qe mund t'ju vijnë ne ndihme studenteve per plotësimin e kërkesave te këtij programi te studimit</p> <p>Ky program studimi nuk parashikon praktika laboratorike</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e arshivuar, informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Infrastruktura që disponon institucioni, është një infrastrukturë moderne që ofron kushtet dhe shërbimin e duhur të nevojshëm për realizimin e programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi. 2. Biblioteka e institucionit ka mjaftueshëm literaturë bashkohore, periodike, revista shkencore dhe mundësi aksesimi në biblioteka online, per stafin e angazhuar në PS Msc. në Administrim Biznesi si dhe për studentët që ndjekin programin e studimeve. 3. Universiteti Epoka ka në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore. <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se standardet e kësaj fushe janë përmbushur.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

GVJ gjatë vizitës në institucion, siguroi informacion shtesë për auditimet e jashtme të Turgut Ozal Education sh.a, pjesë e të cilit është Universiteti Epoka për gjithë periudhën e akreditimit, për Certifikimin ISO, si dhe për procesin e auditimit të brendshëm që Universiteti Epoka ka relaizuar. Mbi shqyrtimin e informacionit nga këto dokumenta të siguruar, GVJ paraqet në vijim analizën dhe konkluzionet për këtë fushë vlerësimi. Referuar tabelës 58, në RVB, institucioni paraqet të ardhurat dhe financimet për vitet akademike nga 2012-2013 deri për 2017-2018 në nivel institucioni. Këto të ardhura, janë siguruar nga të ardhurat nga tarifat e shkollimit, grantet për kërkim si dhe nga aktivitetet tregëtare. Të ardhurat nga grantet për kërkim dhe nga aktivitetet tregëtare kanë filluar nga viti 2015 e në vazhdim. Për vitet 2012-2014, 100% e të ardhurave vijnë prej tarifave të shkollimit. Për vitin 2017-2018, të ardhurat nga tarifat e shkollimit përbëjnë 92.44%, të ardhurat nga grantet për kërkime dhe kontratat përbëjnë 7.25 %, dhe të ardhurat nga



aktivitetet tregëtare 0.3%. Të ardhurat dhe shpenzimet e Turgut Ozal Education sh.a kontrollohen në mënyrë të rregullt çdo vit nga kompani audituese të jashtme. Raportet e hollësishme të këtyre auditeve janë të disponueshme në Zyrën e Financës të Universitetit “Epoka” në çdo kohë dhe një përmbledhje e këtyre dokumentacioneve në vite ju vendos GVJ në dispozicion mbas kërkesës gjatë vizitës në nstitution nëpërmjet sistemit AMS. Të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit janë nën kontrollin e Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a dhe administrohen në bashkëpunim me Zyrën e Financës të Universitetit “Epoka”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim përbëjnë **2.18%** të të ardhurave për vitin 2015, **2.81%**, për 2016, dhe **7.25%** për vitin akademik 2017-2018
- Konsulentat, shërbimet, donacionet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit kanë siguruar **92.44 %** të ardhurave gjatë 2017-2018, **97.85%** për 2016-2017 dhe **97.8%** për vitin 2015-2016.
- Sponsorizimet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Shërbimet trainuese **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Donacionet, aktivitetet siguruese etj **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Aktivitetet tregëtare kanë siguruar **0.3 %** të ardhurave gjatë 2017 dhe 2018.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Tabela 60 dhe 61, paraqet të ardhurat dhe shpenzimet për programin e studimit Msc. në Administrim Biznesi

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion GVJ paraqiti kërkuesin për informacion mbi raportet e auditimit në vite nga 2012-2018 si dhe për procesin e auditimit të brendshëm. Ky informacion u vu në dispozicion nga institucioni, dhe u konsultua nga GVJ përmes sistemit AMS.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së vetëvlerësimit si dhe informacionet shpesh të siguruar gjatë vizitës në institucion, për GVJ rezulton se, Turgut Ozal Education sh.a auditohet çdo vit nga një

<p>studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>kompani e certifikuar auditimi e jashtme, ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ai jep opinionin e tij të pavarur mbi situatën financiare dhe sipas GVB, raporti i detajuar mund të gjendet në zyrën e Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a. a.</p> <p>Raporti përmban të gjitha analizat e të dhënave mbi shpenzimet dhe të ardhurat e shoqërisë dhe institucioneve të përfshira, të gjitha të dhënat kontabël lidhur me të ardhurat (grantet, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë të direkt ose indirekt (duke kontraktuar shoqëri). GVJ iu vendos në dispozicion opinion i audituesit të pavarur per vitet 2012-2016</p> <p>[Dokumenti 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 6.5, Vizita ne institucion].</p> <p>Në këto raporte paraqitet opinion i përgjithshëm i audituesit të jashtëm, për kompaninë në tërësi, <i>por nuk paraqitet informacion për programin e studimit MSc. në Administrim Biznesi.</i></p> <p>GVJ nga vizita në institucion konstatoi se Universiteti Epoka ka ngritur grupe pune për kryerjen edhe të auditimeve të brendshëm. Një plan i këtyre auditimeve dhe i personave përgjegjës për kryerjen e tyre iu vendos GVJ në dispozicion nëpërmjet sistemit AMS.</p> <p>[Dokumenti 17. Decision on Internal Audit Team Members and Timetable.pdf, Vizita ne institucion]</p>
<p>Standardi VL1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit dhe arkivohet në këtë Drejtori. Me finalizimin e raportit të hartuar, të dhënat dhe analizat i komunikohen Universitetit "EPOKA". Universiteti "EPOKA" funksionon me buxhet të pavarur. GVJ, konstaton se në RVB, paraqiten numri i studentëve për 6 vitet, totali i financimeve si dhe kostot/student.</p> <p>Bazuar në raportin financiar zyrtar të Turgut Ozal Education sh. a., dhe në opinionin e kompanisë audituese të jashtme, shoqëria ka qëndrueshmëri financiare që garanton ecurinë e institucionit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ konstaton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti Epoka, ka paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit, tabelën e shpenzimeve dhe të ardhurave në nivel institucioni si dhe në nivel programi studimi. Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifat e 	

studentëve dhe aktiviteti tregtar.

2. Institucioni siguron të ardhura nga grantet dhe projektet prej 2015-2016.
3. Turgut Ozal Education sh. a. bën një auditim të përvitshëm të jashtëm dhe të brendshëm të situatës financiare, ku pasqyrohen burimet e financimit, nga tarifatat studentore, aktivitetet si dhe shpenzimet për të gjithë periudhën që akreditohet ky program
4. Turgut Ozal Education sh. a. harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

GVJ mbështetur në rekomandimin e lënë nga akreditimi i mëparshëm, informacionin e siguruar nga dosja e vetëvlerësimit, si dhe nga informacioni shtesë i siguruar gjatë vizitës në institucion, është i mendimit se institucioni duhet të intensifikojë përpjekjet për të dokumentuar më mirë auditimin financiar lidhur me programin Msc në Administrim Biznesi.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe RVB, konkludon se **standartet e kësaj fushe përmbushen.**

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ në lidhje me përshkrimin mbi termat e referencës së kësaj fushe vlerësimi, është mbështur mbi informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, takimet me përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, me stafin akademik, me drejtues të njësisë bazë si dhe me studentët që ndjekin programin e studimit Msc. në Administrim Biznesi. GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentat e konsultuar nëpërmjet sistemit AMS, konstaton se Sistemi Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në Universitetin "EPOKA" është institucionalizuar dhe funksionimi i këtij sistemi rregullohet me Udhëzimin "Për vlerësimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetin EPOKA. [Dokument 17, Internal quality assurance unit, arkive]. GVJ u njoh me përbërjen aktuale dhe të mëparshme të KPSC, nëpërmjet informacionit nga dosja e vetëvlerësimit. (Tabela 63, 64 në RVB) Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë, që është emrimi i mëparshëm i njësisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përbëhet nga 8 anëtarë, ku kishte përfaqësues të studentëve (1), të ish studenteve (1), si dhe një anëtar i jashtëm, që nuk është pjesë e strukturës së Universitetit Epoka. [Tabela 64, RVB] NJBSC, pranë Universitetit Epoka, pas miratimit të Statutit të ri të Universitetit "EPOKA" në vitin 2017 është riemëruar KPSC. Përgjegjësitë e KPSC në Universitetin Epoka, sanksionohen në statutin e Universitetit, neni 35 [Dokument 9, arkive]. KPSC përbëhet nga 12 anëtarë, ku përsëri përveç numrit në rritje të anëtarëve të KPSC krahasuar me KVAPC, ka përfaqësues nga studentët (1), nga ishstudentët (1), anëtar të jashtëm (1), si dhe pjesë e kësaj strukture është edhe një punonjëse e brendshme e Sigurimit të Cilësisë, që kryen funksionin e koordinatores së KPSC-së. [Tabela 63, RVB] Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) mbështetet në punën e tij nga Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, dhe ka si funksion kryesor sigurimin e cilësisë pranë këtij institucioni. KPSC, me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë kryen vlerësime periodike të aktiviteteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në fund të cdo

semestri organizohet pyetesori per studentet ne lidhje me vleresimin e cilësisë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi të ofruar nga Universiteti "EPOKA".

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

GVJ nga takimet me përfaqësues të KPSC, me stafin akademik, me përfaqësues të zyrës së sistemeve të informacionit si dhe me studentët e programit konstaton, se të gjithë studentët plotësojnë pyetësorët për vlerësimin e stafit akademik në përfundim të çdo semestri. Ata nuk mund të kenë akses dhe nuk mund të informohen për notat e tyre finale, pa plotësuar më parë nëpërmjet sistemit, pyetësorët. Përpunimi bëhet nëpërmjet sistemit dhe stafi akademik siguron informacionin për vlerësimin e bërë nga studentët e programit vetëm mbas finalizimit të rezultateve të lëndës. Ky sistem garanton plotësimin e pyetësoreve nga 100% e studentëve, rrit shpejtësinë në përpunim, realizohet në kohë më të shkurtër, ka normë të lartë të përfshirjes së studentëve dhe ul subjektivizmin e palëve të përfshira në proces. Anketimi ka përmbajtje standarde dhe konsiston në vlerësimin e 14 komponentëve nga ana e studentit që variojnë nga 1 (vlerësimi më i ulët) deri në 4 (vlerësimi më i lartë). Plotësimi i anketimit është plotësisht konfidencial. Me përfundimin e anketës, sistemi elektronik nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog si rezultat i përgjithshëm, si edhe rezultatin për çdo komponent të anketimit, duke treguar edhe renditjen e pedagogëve në nivel Departamenti dhe Fakulteti.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë


Në fund të çdo semestri akademik, KPSC me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, realizon anketimet me studentet e programeve të studimit dhe kryen analiza sasiore dhe cilësore të tyre dhe del me rekomandimet përkatëse, me theks të veçantë të evidentimi i problematikave dhe fushave ku nevojitet përmirësim i mëtejshëm. **[Dokumenti 42, arkive]**. Rezultatet e anketave përcillen te Rektori nga Zyra e Regjistrimit. Rektori shqyrton rezultatet e anketimit dhe ia përcjell KPSC-së që kryen analizë të dhënash për çdo lëndë dhe pedagog dhe i bën rekomandime Rektorit. Përmes mbledhjeve, Rektori garanton që rekomandimet e KPSC-së në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies të zbatohen në nivel Fakulteti dhe Departamenti.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Dekani përkatës i Fakultetit ose Përgjegjësi i Departamentit monitorojne cilësinë e mësimdhënies në Universitetin "EPOKA" nepermjet dëgjimit të shpjegimit të lëndës në auditor dhe monitorimi periodik i punës mësimdhënëse të pedagogut. **[Dokumenti 18, arkive]**

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

GVJ konstatoi gjatë takimit me GVB, se Universiteti "EPOKA" është pajisur me certifikatën ISO 9001 në 2010 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Auditimi i jashtëm i fundit në kuadër të ISO është kryer në mars 2014. Në të njëjtën kohë, në kontekstin e certifikimit ISO për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, KPSC me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, kryen kontrole periodike dhe anketime me secilën njësi akademike dhe administrative të



Universitetit, si dhe përgatit raporte që ia përcjell Rektoratit dhe njësisë përkatëse, në mënyrë që të adresohen mangësitë e identifikuar dhe të zgjidhen problemet e vërejtura në njësitë përkatëse. Gjithashtu GVJ, vlerëson iniciativën e Universiteti "EPOKA" për të ngritur Grupin e Auditimit të Brendshëm, i cili siguron zbatimin e proceseve dhe procedurave të institucionit nepermjet auditeve periodike që kryen.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion, GVJ-se në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, iu vendosen në dispozicion dokumentat e kërkuar, të cilët u shqyrtuan në funksion të konkluzioneve të nxjerra për këtë rubrikë

[Dokumenti 4. Report on Performance of the Academic Staff Evaluation.pdf, vizita në institucion]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); b. Dëgjime në auditor; c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; 	<p>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me përfaqësues të KPSC, dokumentacionit të siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se Universiteti Epoka, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve [Dokumenti 18, Dokumenti 42]</p> <p>Referuar RVB dhe vizitave në institucion, informacioni i kërkuar përfshihet në raportin e vetëvlerësimit institucional dhe atë të programeve të studimit.</p> <p>GVJ gjatë inspektimit të faqes zyrtare të Universitetit Epoka, konstaton se Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html</p> <p>GVJ konstatoi nga dosja e vetëvlerësimit dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion se Universiteti Epoka, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta. Studentët përfshihen në vlerësimin e stafit akademik dhe të ecurisë së programeve të studimit. Në fund të çdo semestri akademik, përmes anketave të përgatitura, studentët japin opinionin e tyre për pedagogun e lëndës dhe përmbajtjen e lëndës. [Dokumenti 42]</p> <p>Metodat indirekte të vlerësimit janë zbatuar përmes një ankete të kryer me studentët, që përmban rubrika të posaçme: Pyetje për përmbajtjen e lëndës; Pyetje për performancën e pedagogut të lëndës; Pyetje për shërbimin e ofruar nga Universiteti "EPOKA" ; Pyetje</p>

<p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>konceptuale ; Rekomandime nga studentët etj.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" publikon rregullisht broshura për vlerësimin e brendshëm. Këto broshura përfshijnë rezultate të anketave periodike të personelit dhe studentëve.</p> <p>GVJ gjatë kontrollit ne faqen zyrtare të Universitetit "EPOKA", konstaton prezantime të ndryshme të publikuara për vlerësimin e brendshëm institucional, vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit të niveleve të ndryshme, si dhe formularë të ndryshëm që përdoren gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm. GVJ konstaton se këto vlerësime janë të azhornuara duke demonstruar se institucioni aplikon rregullisht praktiken e publikimeve te tilla. (http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html)</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti "EPOKA" përgatit analiza vjetore pjese e të cilit është edhe vlerësimi i ecurisë së programeve të studimeve të nivelit të dytë ku përfshihen të dhëna për aspektet akademike, të dhëna për performancën e studentëve, si norma e kalueshmërisë dhe të dhënat për mësimdhënien. [Dokument 4. Report on Performance of the Academic Staff Evaluation.pdf vizita ne institucion]</p> <p>GVJ referuar informacionit të siguruar në institucion dhe nga dosja e vetevlerësimit, konstaton se bazuar në feedback-un e marrë nga studentët, nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve por dhe aktorëve të tjerë, Universiteti Epoka harton politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit. [Dokument 6, Policy on Continuous Improvement of Study Program, Arkive]</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të</p>	

studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Universiteti Epoka ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2017.

[<https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-20-tetor-2017>]

GVJ konstaton se Universiteti Epoka përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë si pyetësorët e studentëve, fokus grupet, dëgjesat në auditor, etj. [Dokumenti 18, Dokumenti 42]

Universiteti Epoka harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre, të cilat realizohen nga KPSC në bashkëpunim me njesinë baze dhe atë kryesore.

GVJ konstatoi se institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit

GVJ referuar RVB dhe vizites në institucion, konstaton se Senati si organi kolegjal vendimmarrës i Universitetit "EPOKA", përcakton politikën e zhvillimit të institucionit, programon, koordinon, drejton dhe kontrollon aktivitetet e mësimdhënies dhe kërkimit, vlerëson efektivitetin e tyre dhe vendos për probleme të rëndësishme të arsimimit dhe kërkimit shkencor. Propozimet për ndryshimin e kurrikulave i përcillen Senatit në përputhje me parimin e hierarkisë vertikale: departamenti - fakulteti - Rektorati.

Para se propozimi për ndryshime në kurrikulat të futet në axhendën e Senatit, ato shqyrtohen nga KPSC

Referuar vizites në institucion dhe dosjes së vetëvlerësimit, GVJ konstaton se Universiteti Epoka organizon trajnime me synim ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e sigurimit të cilësisë në të nepermjet trajnimeve të zhvilluara [Dokumenti 14, 15 arkive]

Universiteti "EPOKA" ka hartuar dhe zbatuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si pjesë e Planit Strategjik të Universitetit "EPOKA" dhe si pjesë e planeve strategjike të departamenteve. Strategjia, politikat dhe procedurat publikohen në planin strategjik të institucionit dhe në planet strategjike të departamenteve. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar në faqen e universitetit. [Dokumentin 5, 17,

Konkluzionet e vlerësimit:

Në lidhje me fushën e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, GVJ nga shqyrtimi i informacionit të siguruar gjatë takimeve në institucion, nga faqja zyrtare e institucionit si dhe nga dosja e vetëvlerësimit, konkludon se:

1. Universiteti Epoka përdor metodologji vlerësimi të konsoliduar, të mbështetur në instrumente matëse dhe vlerësuese për të siguruar një informacion të paanshëm dhe objektiv mbi ecurinë e programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi
2. Institucioni publikon informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm në faqen zyrtare të tij
3. Universiteti Epoka kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë
4. Universiteti Epoka nëpërmjet Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe strukturave të tjera mbështetëse, garanton sigurimin e cilësisë në realizimin programit të studimit Msc. në Administrim Biznesi.
5. Universiteti Epoka ka hartuar në mënyrë të qartë dhe ka konsoliduar tashmë, politikën e procedurës së vlerësimit periodik. KPSC është organi kryesor që realizon anketimet për matjen e performancës së pedagogëve në procesin e mësimor nëpërmjet një procesi që siguron objektivitet dhe normë të lartë përfshirje të të anketuarve.

Nga sa më sipër GVJ konkludon se standardet e kesaj fushe përmbushen.


POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Masteri i Shkencave në Administrim Biznes organizohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, i cili është baza e mbështetjes akademike të këtij programi. Departamenti si përgjegjës për organizimin e këtij programi ka përcaktuar lëndët me zgjedhje dhe ato të detyrueshme dhe është përgjegjës për mbarvajtjen e këtij programi. Objektivi i këtij programi është të përgatisë studentë me kualitete të larta shkencore në fushën e administrim biznesit, duke i vënë studentët në mjedisë reale të zhvillimit të biznesit. Programi nxit mësimdhënie në drejtim të përdorimit të metodave shkencorë të analizës, duke i motivuar studentët të kryejnë analiza në kushtet e zhvillimit të mjedisit në Shqipëri. Objektivi tjetër i këtij programi është të përgatisë menaxherë të ardhshëm të sipërmarrjeve private, duke ndryshuar konceptet dhe mënyrën e menxhimit të ndërmarrjeve (Ref. Faqe 111 i Dokumentit të RVB). Ky program është i



konceptuar me lëndë të metodave të kërkimit shkencor dhe teorive ekonomike në fushat kryesore të menaxhimit të biznesit, si menxhimi strategjik dhe lidershipi, marketingu, menaxhimi i portofoleve dhe i riskut, menaxhimi i taksave etj (**Tabela 66 e RVB**). Programi i Masterit të Sheknace në Administrim Biznes organizohet me studentët me kohë të plotë. Programi konsiderohet i përfunduar kur plotësohen 120 ETCS, i miratuar sipas rregulloreve të Unirsitetit nga Senati Akademik (**faqe 112 e RVB si dhe Aneksi 20 arshiva**). Plani mësimor është i ndarë në 6 fusha sipas veprimtarisë formuese të studentëve, përfshirë edhe tezën. Peshën më të madhe sipas krediteve e zënë veprimtari në disiplina të formimit karakterizues gjithsej **36 kredite**, si dhe teza me **30 kredite** (**Aneksi 20 arshiva dhe Tabela 67 në RVB**).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimi dhe objektivat e programit

Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është licencuar si Diplomë e Nivelit të Dytë me Vendim të KM nr. 908, date 26.08.2009 dhe i është dhënë leja e ushtrimit të veprimtarisë akademike me urdhër nr. 248, datë 06.05.2010 po si DND. Bazuar në ligjin e arsimit të lartë nr. 9741, të vitit 2007, ky program është konvertuar në Master i Shkencave po me 120 ECTS dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike (**Rregullorja e programit Aneksi 26 arshive**).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 26\30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 13\15 javë mësimore në auditor
- 1 vit akademik ka 768 orë mësimore në auditor
- 1 semestër ka 384 orë mësimore në auditor për një lëndë
- 1 ECTS = 25 orë mësimore të punës së përgjithshme për studentin
- 1 orë mësimore (Mësimi) = 60' minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor është i organizuar me 3 semestre, ndërsa semestri i katërt i lihet studentit për përgatitjen e tezës. Plani mësimor është i organizuar në pesë fusha veprimtarie, ku veprimtari në disiplina të formimit karakterizues, zënë 36 kredite (Veprimtaria B), disiplina të ngjashme integruese dhe ato me zgjedhje përfshijnë 34 kredite (Veprimtaria C dhe D), ndërsa lëndët e formimit të përgjithshëm zënë 14 kredite (**Tabela 67 e RVB**). Shpërndarja e krediteve sipas lëndëve të ndarë sipas 3 semestreve gjëndet në **Tabelat 65 dhe 66 te RVB**. Nga ky informacion shikohen keto karakteristika të vecanta të këtij programi:

Së pari, programi është pothuajse i **standartizuar** për cdo lëndë me peshë të njëjtë në kredite **prej 6 kreditesh ECTS**, gjatë vitit të parë. Peshë e krediteve ndryshon gjatë vitit të dytë të programit mësimor, kryesisht në lëndet me zgjedhje.

Së dyti, e cila rrjedh nga karakteristika e parë, cdo lëndë ka të njëjtat orë mësimore, **prej 3 orësh në javë**, të **paspecifikuar** dhe ndarë se cpjesë të këtyre orëve janë detikuar seminareve, laboratorëve apo praktikave.

Së treti, të dy semestrat kanë një numër të mjaftueshëm lëndësh me zgjedhje, por që nuk justifikohet me numrin e kufizuar të numrit të studentëve që ky mastër ka, pasi gjithsej, psh në semestrin e dytë janë 8 lëndë me zgjedhje kundrejt dy mundësive për zgjedhje me 8 kredite sejcile lëndë (Tabela 66 e RVB).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- | | | |
|------------------------------|------------------------|-------------------------------------|
| • Për leksionet | 720 orë në auditor dhe | 2022 orë punë e pavarur e studentit |
| • Për Seminaret | 152 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit |
| • Për Laboraret | 0 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit |
| • Për Praktikat lëndore | 0 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit |
| • Për Praktikën Profesionale | 0 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit |
| • Provimi përfundimtar | 14 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit |

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Referuar Tabelës nr 69 të RVB, e cila ka për qëllim të tregojë ndryshimet e ECTS për lëndët sipas vitit të fundit akademik në krahasim me programin të licensuar vërehet se këto ndryshime përfshijnë 30 ECTS. Sipas analizës së të dhënave të kësaj table shikohen këto ndryshime.

Së pari, është shtuar 1 kredit për 9 lëndë duke i kaluar këto lëndë nga 5 kredite (ETC) në 6 kredite (ETC). Por kjo rritje me 1 kredit për ETC është shoëruar me ulje të orëve të mësimit nga 4 orë mësimi në javë 3 orë mësimi në javë, gjë e cila në kushte normale duhet të ndodhte e kundërta.

Së dyti, janë rritur 6 kredite, për dy lëndë me zgjedhje dhe për lënden "Menaxhim operacional" duke i kaluar këto lëndë nga 6 në 8 kredite ECTS, dhe duke shtuar orët e mësimit në auditor nga 6 në 8 orë.

Së treti, seminarët në administrim biznesi janë pakësuar me 4 kredite dhe nga 12 kredite janë bërë 8 kredite ECTS, duke ndryshuar respektivisht orët e mësimit në auditor, nga 12 orë në 8 orë mësimi në javë.

Së katërti, bilanci i krediteve të shtuara dhe pakësuara për lëndët ekzistuese është 11 kredite shtesë, e cila do të thotë që nga programi janë pakësuar dy lëndë nga programi i licensuar, ose më pak se 9% e totalit të krediteve për ndryshim programi e cila është brënda limitit që ka institucioni për ndryshimin e këtij programi.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Tabela 68 e RVB dhe Anexi 9 me dokumentat shtesë jep shpërndarjen e pedagogëve sipas lëndëve të Programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi si dhe ngarkesën e pedagogëve në semestrin e parë dhe të dytë të këtij programi. Ngarkesa e pedagogëve të përfshirë në programin Msc është relativisht e lartë dhe shkon nga 14 deri në 20 orë mësimi në javë. Kjo ngarkesë përfshin mësimdhënie për bachelorin masterin profesional dhe masterin e shkencave në administrim biznes. Nisur nga Anexi 6 tregohet se pedagogët e përfshirë në këtë program kanë një ngarkesë më të madhe se dy leksione në javë. Kjo ngarkesë është më e lartë vecanërisht për

pedagogët: Xhimi Hysa, Alba Kruja dhe Teodor Duman, te cilët janë të përfshirë në më shumë se tre cikle leksionesh në jave për studentet e bachelorit dhe masterit.

Nga shqyrtimi i CV te stafit me kohë të plotë të angazhuar në programin Mastër i Shkencave në Administrim Biznes shikohet se 5 nga 6 pedagogët e angazhuar në procesin mësimor kishin CV të plota dhe karrierë profesionale dhe akademike të përshtshëm për lëndet në të cilat ata ishin të anagazhuar, me përjashtim të **Vusal Gambarov**, i cili kishte një CV jo adekuate për lëndën dhe pozicionin që ai ka në këtë program, pasi në CV **nuk pasqyrohet asnjë eksperiencë të lidhur me mësimdhënien si dhe botime shkencore të kryera** nga ky pedagog.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe intervistat e kryera me stafin akademik, u vlerësua roli që kishte udhëheqësi i cdo lënde në ndërtimin e syllabuset dhe mënyra e ndryshimit të tyre. U konstatua se syllabuset ishin të pandryshura për sa kohë përgjegjesi i lëndës kishte ndërmarrë ndryshime të syllabusit në vitin e parë të mësimdhënies. Këto ndryshime bëheshin në departament përpra fillimit te vitit shkollor. Forma e syllabuseve ishte standarte për të gjitha lëndet dhe ishte e publikuar ne faqen e programit. Syllabusi përmban këto elementë kryesorë,

- Kodin e lëndës
- Numri i krediteve
- Emri i udhëheqësit të lëndës
- Përshkrimi i lëndës
- Objektivat e lëndës
- Temat qe përmban lënda
- Teksi kryesor dhe literatura mbështetëse
- Refeneca të tjera literature
- Rezultatet dhe qellimi i programit të lëndës
- Metodot e vlerësimit dhe pesha e tyre

Metodat e vlerësimit ishin të ndryshme dhe përcaktoheshin individualisht nga cdo udhëheqës lënde. Kështu përshembull në sillabusin e lëndës “Biznesi Ndërkombetar” pesha e provimit përfundimtar ishte 30%, kundrejt 70% që ishte pesh e të gjithë metodave të tjera, si kolokiumi i ndërmjetëm, pjesëmarrja, detyrat në grup dhe individuale (**Tabela 70 e RVB**).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi i studimit Msc në Administrim Biznes është licensuar që nga viti 2009, pranë Universitetit Epoka, dhe me Urdhër Nr. 286, datë 06.07.2012 është akredituar për herë të parë.
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Ky program është i organizuar me module të vlerësuara me kredite te transferueshme dhe të aplikuar për studentët që kanë të transferuara

	<p>kreditet e tyre si në universitetet e tjera brënda vendit ashtu edhe jashtë.</p> <p>Ky PS është me 120 kredite dhe ofrohet në 2 vite me 4 semestra. Per cdo vit me kohe të plotë jepen mesatarisht 60 kredite (Aneksi 20 arshive).</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>PS Msc në Administrim Biznes është konceptuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjinë e institucionit dhe specifikisht këtij programi studimi, për ti përgatitur studentët me njohuri të thella shkencore me qëllim përdorimin e njohurive të thella shkencore në fushën e përdorimit të medodave të kerkimit shkencor.</p> <p>Nga vizita në institucion e Grupit të eksperteve të jashtëm të vlerësimit u konkludua se ky program është modeluar tju shërbejë studentëve që kërkojnë të arrijnë njohuritë e thella shkencore në fushën e programit të administrim biznesit, me qëllim që një pjesë e studentëve të ndjekin ciklin e trete të studimeve të doktoraturës (Rregullorja e programit Aneksi 26 arshive).</p> <p>PS i studimit gjithashtu afron mundësi të mira që studentët të kryejnë studimeve të mirëfillta të aplikueshme për sektorë të ndryshëm të biznesit në Shqipëri, duke i përgatitur më mire këta studentë me kompetenca profesionale në sektorët dhe kompanitë që ata punësohen.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin</p>	<p>Programi i hartuar për këtë cikël studimi ishte në përputhje me objektivat e strategjisë 2012/2017 dhe me draftin e ri që ishte në proces miratimi nga strukturat përkatëse të universitetit Epoka.</p> <p>Nga shqyrtimi i RVB dhe gjatë takimeve në institucion GVJ konstatuan se kontrolli i studenteve bëhej me forma të larmishme, duke u nisur nga</p>

Krye Ojuz

përkatës të studimeve.	provimi i ndërmjetëm ai përfundimtar detyrat e kursit, ushtrimet në klasë, etj. Cdo pedagog ishte fleksibël në përcaktimin e peshës së vlerësimit për cdo lëndë. Kjo mënyrë vlerësimi në gjykimin e GVJ nuk i shërben plotësisht zbatimit të këtij kriteri, pasi fleksibiliteti i përcaktimit të peshës së vlerësimit duhet të bëhet sipas një hapësire të përcaktuar në rregulloren programit.
------------------------	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Administrim Biznesi është krijuar nga përvoja më e mire e stafit akademik, i cili është përzgjedhur në baze të standarteve rigorizisht të përcaktuara. Cdo lektor duhet të kishte gradën shkencore PHD dhe një përvojë pune 3 vjeçare në mësimëdhnie, gjë që kishte bërë të mundur që programi dhe silabuset të ndërtoheshin në përvojën më të mirë ndërkombëtare (Aneksi 31 guida e stafit).</p> <p>Mënyra e vlerësimit për cdo lëndë, si dhe silabuset e ndërtuara ishin mjaftueshmërisht të përgatitura që të ishin të pranuar nga universitetet e tjera në Evropë dhe SHBA, pasi mjaft studentë kishin arritur të siguronin programe semestrale në bashkëpunim me këto universitete.</p> <p>Programi merr parasysh kriteret ligjore shqiptare dhe është teknikisht i përputhur edhe me Sistemin e Bolonjës.</p>
---	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Të gjithë studentët që përfundojnë këtë PS përgatisin një punim shkencor në formën e temës së masterit, e cila vlerësohet mbi kriteret e sakta shkencore dhe luftën kundër plagjiaturës. Në raste të vecanta studentët përfshihen edhe në punën shkencore të stafit akademik (Aneksi 5 shtesa e dokumentave).</p> <p>I gjithë stafi akademik vecanerisht ai me kohë të plotë anagazhohet në punën kërkimore shkencore. Kjo gjë realizohet edhe nëpërmjet stimulit financiar për cdo botim në revista me faktor impakti. Fushat kërkimore kryesore ku është anagazhuar stafi akademik janë biznesi social dhe qëndrueshmëria ekonomike, marketingu, politika e SME dhe sjellja organizative dhe roli i udhëheqësisë.</p> <p>Puna kërkimore shkencore është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të programit të Masterit</p>
---	---

	shkencor në Administrim Biznes. Angazhmi i stafit në punën kërkimore është i lidhur drejtpërdrejt në nxitjen në pjesëmarrjen në konferenca dhe publikimin në revista me faktor impakti. Një tjetër mënyrë e tërheqjes së stafit akademik në punën shkencore është angazhimi në projekte të ndryshme të financuar drejtpërdrejt nga institucioni ose në projekte të mbështetura kryesisht nga programet e Bashkimit Evropian.
Standardi I.7 – Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	N/A
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Sic u theksua me lart institucioni nuk paraqiti një studim të mirefilltë tregu për këtë program, por bazohet në studimet individuale në kuadër të kërkimit shkencor për segmente të caktuara të tregut, si dhe bazohet në studimet e kryera nga institucionet e specializuara në fushën e studimit të nevojave të tregut në Shqipëri.</p> <p>Por megjithatë mbi 90% e studentëve që mbarojnë këtë program sigurojnë punën që në 6 muajt e parë pas mbarimit gjë që tregon domosdoshmërinë e këtij programi për tregun e punës.</p> <p><i>Ngelet detyrë në të ardhmen kryerja e studimeve më të detajuara në mënyrë që të percaktohen më mirë përshtshmëria e mundësive të punësimit të studentëve me nevojat e tregut sipas degeve dhe sektoreve të vecantë.</i></p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtarë;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>I gjithë programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze, por nuk bie ndesh me interesat kombëtare, përkundrazi i ndihmon studentët shqiptarë për tu integruar më mirë në tregun e punës si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit (Regullorja e programit Aneksi 26).</p> <p><i>Megjithatë në program duhet të ketë një lëndë me zgjedhje, e cila mund të ndihmonte studentët të njihen më mirë me trashëgiminë kulturore dhe gjeografinë ekonomiko administrative të ofruar në</i></p>

ky @yp

	<i>gjuhen shqipe.</i>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznes zhvillohet me 120 kredite ne 4 semestra për 2 vite akademike. 30 kredite ECTS i përkasin tezës së masterit që zhvillohet semestrin e 4 të.
Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	N/A
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	N/A
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Nga informacioni i dhenë në RVB si dhe kontaktet me stafin akademik GVJ konkludoj se silabuset janë të publikuara ne web sitin e Universitetit dhe janë lehtësisht të aksesueshme. Cdo staf i ri akademik rishikon silabusin e lëndës për të cilën ai është caktuar në bazë të eksperiences së tij më të mirë duke i miratuar këto ndryshime në departamentin përkatës. Por nuk ka një përqindje se sa është masa e ndryshimit të silabusit të ri me atë ekzistues. Sudenteve ju behet i njohur programi i lëndës dhe kërkesat përkatëse që përcaktohen në silabus, gjatë orës së parë të mësimit.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Sipas RVB dhe rregullores se masterit shkencor ne administrim biznesi, te gjithë studentët duhet të përgatisin nje tezë punimi, i cili fillon pasi kanë plotësuar të gjitha kreditet për lëndët me zgjedhje dhe ato detyruese. Studentit mund ti lihet edhe afat për rishikimin e tezës në bazë të verejtjeve të bëra nga juria e caktuar për vlerësim. Per tezën janë parashikuar 30 kredite.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është i organizuar sipas standarteve dhe kriterëve ligjore në fuqi dhe i harmonizuar me kriteret e Bolonjës.
2. Ky program është në përputhje me strategjinë e programit dhe synon tu ofrojë studentëve cilësi dhe aftësi të mira për kërkimin shkencor, duke ju dhënë një peshë të rëndësishme pikëve për tezën e formimit si dhe duke i ftuar studentët në punë kërkimore.
3. Syllabuset janë të përgatitura në një formë standarte për të gjitha lëndët, mësimore dhe ato janë të aksesueshme mirë nga studentët qoftë nëpërmjet web sitit, si në formën informative në orën e parë të mësimit.
4. Të gjitha lëndët e PS zhvillohen në gjuhën angleze, ato nuk bien ndesh me interesat kombëtare, megjithatë vendosja e ndonjë lënde me zgjedhje në gjuhën shqipe do të shërbente më mirë promovimit të kulturës dhe traditës shqiptare .
5. Studentët pas përfundimit të studimeve arrijnë të integrohen mirë në tregun e punës, megjithatë, nga ana e Departamentit nuk ka studime të mirëfillta tregu, për ti paraprirë ndryshimit të kërkesave për këtë specialitet në të ardhmen.

Nga sa më sipër GVJ konkludon se standardet e kesaj fushe përmbushen kryesisht.

Institucioni duhet të kryejë studime tregu më të specializuara për të siguruar përshtatshmërinë e programit mësimor me nevojat e tregut.

Gjithshtu të shikohet mundësia e përfshirjes në këtë program së paku një lëndë me zgjedhje në gjuhën shqipe me qëllim promovimin më të mirë të kulturës dhe traditës shqiptare.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia, krahas punës shkencore, është një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Universitetit Epoka në përgjithësi, ashtu sikurse edhe për programin mësimor Master i Shkencave në Administrim Biznes. Procesi i mësimdhënies është i organizuar në 4 semestra. Në tre semestret e parë puna mësimore konsiston në leksione, seminare, si dhe në punë të pavaruar të studentëve, të cilat kontrollohen nga ana e pedagogut të lëndës. Semestri i katërt i dedikohet totalisht përgatitjes së tezave (**Rregullorja e programi dhe curiculat Aneksi 26 dhe 20 arkiva**). Mësimdhënia zhvillohet tërësisht në gjuhën angleze, duke i aftësuar studentët me njohuri të plota dhe përdorimin e kësaj gjuhe lehtësisht për të vazhduar ciklin e tretë të studimeve jashtë vëndit, por edhe për tu integruar më mirë me tregun e punës në Shqipëri. Cdo lektor, pasi ka marrë miratimin për programin e lëndës, ka të depozituar në departament të gjitha materialet didaktike që ai do të zhvillojë mësimin, pëfshirë, leksionet në format poër point, çord, si dhe të gjitha materialet e tjera shoqëruese të leksioneve dhe ushtrimeve që zhvillohen në seminar. Të gjitha këto materjale janë lehtësisht të aksesueshme nëpërmjet faqes online nga studentët. Cdo student plotëson një pyetor

mbi cilësinë e mësimëdhines mbi bazën e të cilave, njësia e kontrollit të cilësisë analizonte rezultatet për cdo pedagog. Ky pyetsor ishte i detyrueshëm për cdo student, pasi mos plotësimi i këtij pyetsori nuk lejonte cfaqjen e vlerësimit për lëndën (**Dokumenti shtese i paraqitur ne pas intervistes**). Në raste shumë të ralla pedagogu largohej nga detyra për vlerësim të dobët, e cila flet për një përzgjedhje cilësore të stafit pedagogjik. Studentët kontrolloheshin në forma të ndryshme, mënyra e të cilit pëcakohej nga cdo pedagog në mynyrë specifike. Edhe pesha e vlerësim për cdo kriter vlerësues pëcakohej nga vetë pedagogu, si për vlerësim e provimit përfundimtar, kolokiumit, pjesëmarrjen detyrat jashtë klase etj. Përgjithësisht provimi ishte në formë të shkruar, por jo i sekretuar, për cdo student. Cdo student që kishte kundërshtim për vlerësimin shkonte drejpersdrejti në komisionin e rivlerësimit. GVJ ju vunë në dispozicion disa praktika të tilla. Vlerësimi i studentëve në këtë program bëhej i unifikuar si për gjithë studentët e Universitetit Epoka, në bazë të sistemit amerikan nga 0.00 në koeficientin 4.00, duke bër konvertimin e këtij sistemi në sistemin shqiptar në bazë të një tablele sqaruese. Në Tabelën 71 të RVB së jepet konvertimi i këtij sistemi në pike deri në 100 dhe sistemin Shqiptar. Nota kaluese ishte 1.50 që i pergjigjej notës 6 me sistemin shqiptar (**Aneksi 26 Rregullorja e programit**).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies, sipas **Tabelës 72 të RVB dhe Aneksit 20**, janë si vijon:

• Leksione	616 orë në auditor
• Seminare	152 orë orë në auditor
• Ushtrime	0 orë në auditor
• Laboratore	0 orë në auditor
• Praktikë lëndore	0 orë në auditor
• Praktikë profesionale	0 orë në auditor
• Total	768 orë

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të dijeve përfshijnë provimin përfundimtar, testimet gjatë vitit, plotësimin e detyrave gjatë vitit si dhe pjesëmarrja e lëndës në mënyrë aktive. Peshat specifike e sejcilës nga këto forma në vlerësimin përfundimtar pëcaktohet në silbasut e cdo lënde në mënyrë jo të unifikuar.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Sipas **RVB ne Tabelën 74** jepen të dhëna për aktivizimin e studentëve në aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me pedagogë, department apo fakulteti, por nuk ka të dhëna specifike se sa studentë të Masterit Shkencor në Administrim Biznes janë përfshirë në këto projekte.

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Universiteti Epoka është pjesë e sistemit arsimor shqiptar dhe si i tillë pranimet e studentëve për programin Master i Shkencave në Administrim Biznes, bëhen duke respektuar datat dhe procedurat e ndjekura nga Ministria e Arsimit, sipas Ligjit të ri të Arsimit të Lartë.

Pranimet e studentëve që kanë mbaruar Bsc në Universitetin Epoka bëhen me mesataren 2.50 ekujvalente me notën 7. Ndërsa për studentët e tjerë përveç mesatares merret parasysh edhe intervista me gojë që cdo kandidat kryen me Komitetin Shkencor të Departamentit. Po kështu si kriter pranimi është edhe niveli B2 i gjuhës angleze, nga provimet e njohura ndërkombëtarisht.

Rregjistrimet e studentëve në programin Masteri i Shkencave në Administrim Biznes

Numri i studentëve të regjistruar dhe diplomuar në Msc Administrim Biznesi				
Viti akademik	Studentë të regjistruar për herë të parë	Koeficienti i mesatares në hyrje	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa përsëritur vitin akademik)	Koeficienti i mesatares në dalje
2013 - 2014	10	3.03/4	0	-
2014 - 2015	22	2.77/4	11	3.3/4
2015 - 2016	7	3.14/4	2	3.58
2016 -2017	12	3.19/4	0	-
2017 - 2018	13	2.93/4	0	-

Të dhënat janë marrë gjatë vizitës në institucion

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia e studentëve në hyrje për Masterin e Shkencave në Administrim Biznesi është relativisht e lartë. Koeficienti i pranimit në hyrje jepet më lart. Po kështu edhe rezultatet në mbarimin e ciklit të dyte janë të larta. Kështu në vitin 2014 mesatarja sipas sistemit amerikan ishte 3.3 dhe në vitin 2015 koeficienti ishte 3.58 (Tabela 34 e dokumentave në sistem)

Studentë të regjistruar në vitin e parë (për herë të parë) nota mesatare

Në vitin akademik 2014 - 2015 janë diplomuar 11 studentë me mesatare note sipas sistemit amerikan 3.4, ndërsa në vitin akademik 2015 - 2016 janë diplomuar 2 studentë me koeficient 3.58. (Tabela 34 e dokumentave në sistem)

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Sipas Tabelës 77 të RVB gjithsej në këtë program janë transferuar **9 studentë**, Konkretisht:

- Për vitin akademik 2011 - 20121 studentë
- Për vitin akademik 2012 - 20133 studentë
- Për vitin akademik 2013 - 2014.....2 studentë
- Për vitin akademik 2014 - 2015.....3 studentë


Informacion më i hollësishëm për transferimet e brendshme jepen në **Tabelën 78 të RVB**.

☑ Të dhëna për punësimin e studentëve


Zyra e karrieres dhe e Planifikimit ndjek ecurinë e studentëve dhe integrimin e alumni në tregun e punës. Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe RVB, GVJ konstantoj se ky informacion është i plotë dhe dinamik. Sipas **Tabelës 78 të RVB** së nga 56 studentë të diplomuar ne Master Shkencor Administrim Biznes, vetëm 4 prej tyre nuk janë të punësuar në përputhje me kualifikimin e diplomës, **ndërsa 46 studentë janë punësuar në përputhje me diplomën**. Të pasistemuar në punë mbeten 6 studentë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	<p>Kërkesa minimale për pranimin e të gjithë studentëve në PS Master i Shkencave në Universitetin Epoka është zotërimi i një diplome Bachelor. Universiteti aplikon kriteret shtesë në bazë të rregullores së masterit si: mesatarja e notës 7 te ekujalentuar, si dhe zotërimin me një certifikatë të njohur të gjuhës angleze.</p> <p>Pranimi bëhet sipas kriterëve ligjore në përputhje me legjisllacionin në fuqi.</p> <p>Nga takimet dhe vizita në institucion GVJ konstaton se dokumentacioni i pranimi të studentëve ishte i plotë dhe i rregullt për të gjithë studentët që përzgjedhëm me zgjedhje të rastësishme nga ana e grupit të vlerësuesve të jashtëm (Aneksi 31 dhe 32 pranimi I studentëve dhe matrikullimi).</p> <p>Sic është theksuar i gjithë programi mësimor zhvillohej në gjuhën angleze, si dhe gjithë literature kryesore dhe plotësuese për cdo lëndë ishte në gjuhën angleze. Kjo kishte sjell një rritje të mobilitetit të studentëve në vitet e fundit.</p>
Standardi IV.2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	



<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentët kishin informacion e duhur në lidhje me mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve. Kjo gjë ndihmohej edhe për faktin e marrëveshjeve të shumta që kishte ky universitet me kompani dhe institucione publike dhe private për të realizuar praktikantët mësimorë, duke krijuar mundësi për lidhje të rëndësishme për sigurimin e një pune pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Nga kontaktimi me studentët u konkludua se ata ishin të mirëinformuar për procesin e akreditimit dhe ishin të përfshirë në këtë proces.</p> <p>Shërbimi i këshillimit të karrierës ishte i ngritur dhe funksional. Sistemi informatik i përdorur nga universiteti lejonte të mbaheshin kontakte me alumni edhe pas përfundimit të ciklit të programit mësimor.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Universiteti Epoka ka një system të dyfishtë informacioni dhe baze të të dhënave, për numrin e studentëve të regjistruar dhe ecurinë e studentëve gjatë procesit mësimor. Sistemi informatik i krijuar lejon një monitorim të kryqëzuar të studentëve si nga ana e pedagogut të lëndës ashtu edhe nga sekretaria</p> <p>(Aneksi 33 staf guide).</p> <p>Nga ana tjetër ekzistonin sipas standarteve ligjore dhe rregulloreve të universitetit regjistri i regjistrimit të studentëve, si dhe regjistri i vlerësimeve për çdo lëndë.</p> <p>Nga kryqezimi i këtyre regjistrave me listat e notave të bëra nga GVJ me zgjedhje të rastësishme, rezultojnë një plotësim i saktë dhe korrekt të këtyre regjistrave dhe nuk u konstatua asnjë pargullsi në plotësimin e tyre.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Zyra e karrierës ka informacione të plota mbi ecurinë e alumini dhe karrierën e tyre. Këtë ata e kanë realizuar nga kontaktet e drejtpërdrejta si dhe përdorimin nga alumni të domeinit zyrtar të adresës së emailit të universitetit.</p> <p>Po kështu institucioni ka informacion të sistemuar në data baze mbi studentët që kanë vazhduar ciklin e tretë të studimeve apo ata që janë transferuar.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	



<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Nga vizita ne institucion GVJ konstoj se studentët ishin të mirëinformuar për programin studimor dhe aresyen pse e kishin zgjidhur këtë program studimi.</p> <p>Ata ishin të informuar për procesin e akreditimit dhe një pjesë e tyre ishin pjesë e grupeve të punës për përgatitjen e RVB.</p> <p>Përgjegjësit e lëndëve informonin studentët për programet dhe studentët ishin në dijeni të plotë për ecurinë e tyre.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Studentet që ndjekin aktualisht programin këshillohen sa herë që ata kanë nevojë për ceshtje të ndryshme, pasi dinë personin mbi të cilën tutoron ecurine e tyre, si dhe zyrën e karrierës</p> <p>(shtojca 5 ne dokumentat shtese).</p> <p>Studentët kanë mundësi të medha zgjedhje për kryerjen e praktikës mësimore, për shkak të marrevëshjeve të shumta të bashkëpunimit që ka ky universitet.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti Epoka ka standarte të mirëpërcaktuara për pranimin në PS Master i Shkencave në Administrim Biznes. Këto kritere të mirpërcaktuara kanë bërë që në këtë universitet të vijnë studente me rezultate relativisht te larta nga cikli i parë i studimeve. 2. Institucioni ka informacion të detajuar dhe kompleks për regjistrimin, ecurinë dhe karrierën e studentëve, duke prodhuar në kohë reale statistika përgjithësuese për këta studentë. 3. Studentët janë të mirëinformuar për procesin e akreditimit, dhe kanë marrë pjesë aktive në përgatitjen e RVB 4. Studentët ndiqen dhe konsultohen gjatë procesit të ndjekjes se ciklit mësimor dhe praktikës. <p>Nga sa më sipër GVJ konkludon se standardet e kesaj fushe përmbushen.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.


10. Kërkimi shkencor **Pjesa përshkrimore**

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor është një komponent i rëndësishëm i programit të studimit. Politikat e kërkimit shkencor konsistojnë në tre shtylla.

Së pari, në përzgjedhjen e tematikave dhe fushës së kërkimit shkencor në përputhje me nevojat e vendit;

Së dyti, në përfshirjen e studentëve në fushën e kërkimit shkencor;



Së treti, në nxitjen financiare që ju bëhet stafit pedagogjik për të mundësuar pjesëmarrje ne konferenca dhe vecanërisht në botime ne revista me faktor impakti.

Sipas Tabelës 79 të RVB së fushat kryesore të kërkimit shkencor të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi përfshijnë biznesin social, si risi e re në tregun shqiptar, marketingu i shërbimeve, studimi i SME dhe kultura organizative. Për cdo fushë të kërkimit shkencor janë përcaktuar pedagogë sipas fushave të interesit shkencor. Cdo pedagog depoziton publikim e bërë i cili pasqyrohet në databazin e institucionit njëkohësisht shënjestrohet edhe tek programi Google publishing për të parë ecurinë e kuotimeve të këtyre publikimeve. Cdo lektor ka një buxhet prej rreth 500 Euro ne vit për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe për cdo publikim në revista të referuar autori përfiton një shpërblim deri në 1500 Euro (**Aneket 34 dhe 35 ne arkive**).

Puna kërkimore shkencore është e lidhur gjithashtu me pjesëmarrjen e stafit pedagogjik në projekte të ndryshme, kryesisht të financuara nga Bashkimi Evropian.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Sipas Tabelës 80 të RVB së, nga viti 2012 deri më sot nga personeli akademik i programit të Masterit Shkencor për Adminsitrim Biznes janë publikuar **82 artikuj**, si kontribute në konferenca të ndryshme apo artikuj të botuara ne revista te referuara. Ndersa artikuj të botuar nga stafi akademik në bashkëpunim me student të këtij Masteri janë 16 artikuj (**sipas Tabelën 81 të RVB**). Sipas Tabelës 82 e RVB së shihet se nga stafi akademik nga muaji mars 2012 deri në janar të vitit 2017 pedagoget kanë qenë prezent në **11 konferenca ndërkombëtare**. Nga studentët jane ndjekur gjithsej **13 konferenca**.po kështu janë shënuar edhe dy aktivitete të tjera me qëllim trajnimin dhe këshillimin.Në kuadër të projekteve të financuar nga vetë universiteti Epoka gjatë kësaj periudhe janë financuar **6 projekte**. Financimi për cdo projekt sipas informacionit të mbledhur nga GVJ ishte rreth 2000 Euro dhe kishte për qëllim qe nga rezultatet e projektit të publikoheshin artikuj.Projekte të financuara jashtë institucionit perfshinin projektet të financuar në kuadrin e programit Tempus, i cili kishte si tematike përmirësimin e kurikulave ne fushën e televizioni digital dhe multimedias.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Nga RVB dhe vizita ne institucion GVJ konstatoj se personeli akademik është plotësisht i anagazhuar ne kërkimin shkencor, vecanërisht nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca shkencore, publikimeve dhe pjesmarrje në projekteve të ndryshme, duke kontribuar ne zhvillimin e shkenës dhe kërkimit shkencor.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një	

personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Gjithë PS bëhet në gjuhën angleze. Për rrjedhojë stafi akademik ka gjuhë pune këtë gjuhë. Po kështu gjithë stafi akademik ka kryer një prej cikleve akademike në një universitet të huaj dhe ka një përvojë së paku 3 vjetare në mësimdhënie.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësues-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni ka një kuote financiare për cdo pedagog për pjesëmarrje së paku në një konferencë ndërkombetare jashtë vendit. Po kështu për cdo pulikim stafi akademik merr një shpërblim të caktuar kur ky botim bëhet në një revistë të referuar.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Sipas RVB institucioni ka një informacion të plotë dhe një bazë të dhënash për të gjithë aktivitetin e kërkimit shkencor, duke përfshirë kopje të artikujve të botuar, si dhe informacionin e plotë për pjesëmarrje në konferenca apo projekti ku institucioni është përfshirë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Stafi akademik është i përfshirë në kërkimin shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, botimin e artikujve në revista me impakt, si dhe në projekte të ndryshme. 2. Institucioni mbështet në mënyrë të kënaqshme kërkimin shkencor, nëpërmjet një financimi fiks për cdo lektor për pjesëmarrje në konferenca. Një shpërblim më i madh parashikohet për botim në revista të referuara. 3. Institucioni ka informacion të plotë dhe evidencë për botimet e kryera nga stafi akademik, dhe ndaj referimet e këtyre artikujve nëpërmjet programit Google publications. <p>Nga sa më sipër GVJ konkludon se standardet e kesaj fushe përmbushen.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore


Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Universiteti Epoka ka një strategji të qartë për zhvillimin shumë planesh të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe bashkëpunimin me publikun shqiptar dhe institucione publike dhe komunitetin e biznesit. Për të zhvilluar këtë bashkëpunim funksionon Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare me vartësi nga zyra e rektoriatit. Një nga programat më të rëndësishme të bashkëpunimit ndërkombëtar është marrëveshja me Universitetin e shkencave të aplikuara të Mainzit në Gjermani, me ndikimin të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e punës së Masterit Shkencor në Administrim Biznes, pasi ka rritur mjaft mobilitetin ndërmjet studentëve të këtij programi nëpërmjet programit të shkëmbimit semestral të studentëve. Po kështu kjo zyrë ka objektiv të saj promovimin e imazhit të Universitetit ndërkombëtar, si një institucion me kapacitete të rëndësishme të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë mënyrë është bërë i mundur që Universiteti Epoka të jetë pjesë e një rrjeti universitetesh Evropiane të cilat kanë bërë të mundur të jenë fituese e një projekti që financohet nga programi shumë konkurrues i financuar nga Bashkimi Evropian Horizont 2020. Aktivitete të tjera të ZMN përfshijnë, promovimin e kulturës globale tek studentët dhe përfitimet nga ndryshimi i mjedisit të mësimarrjes në universitete të tjera ndërkombëtare. Informacion të kompletuar për mundësitë e vazhdimin të studimeve në ciklin e tretë të studimeve, si dhe ndjekjen e konferencave shkencore, seminareve dhe mundësive për zhvillimin e projekteve të ndryshme nga ana e fakulteteve dhe departamenteve të universitetit. Në këtë mënyrë kjo Zyrë ka bërë të mundur zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërkombëtare vecanarisht Universitete të ndryshme kryesisht në Evropë por edhe në ShBA dhe gjatë. Këto marrëveshje në më të shumtën e rasteve janë funksionale dhe ZMN shikon mbarëvajtjen e tyre. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni është një tjetër njësi në nivel Universiteti e cila kontribuon për integrimin e studentëve në tregun e punës në Shqipëri, për të zhvilluar një dialog të qëndrueshëm të Universitetit me botën e biznesit dhe për të krijuar marrëdhënie të qëndrueshme me institucionet publike në nivel lokal dhe atë kombëtar. Një aspekt tjetër i punës së ZPKA është ti mundësoj stafit akademik të sigurojë të dhëna të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor, si dhe bashkëpunimin me institucionet që janë prodhuese dhe përdoruese të informacionit statistikor, si INSTAT, Banka e Shqipërisë, shoqatat e Biznesit etj. Studentëve ju vjen shumë në ndihmë kjo Zyrë për të njohur më mirë karakteristikat e tregut të punës në Shqipëri në mënyrë që ata të orientohen në drejtim të zhvillimit të karrierës pas mbarimit të ciklit të dytë të studentëve. Mbi këtë bazë ZPKA ka mundësuar zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me institucionet publike dhe private nëpërmjet marrëveshjeve funksionale.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në projekte të ndryshme kombëtare kanë marrë pjesë gjithsej 12 anëtare të stafit akademik të Universitetit Epoka. Gjithsej ka patur 33 Leksione të hapura nga lektorë të huaj. Po kështu janë 18 student të huaj që kanë ardhur në kuadër të



projektive të bashkëpunimit dhe mobilitetit kundrejt 59 studentëve të Univesristetit që kane shfrytëzuar këtë bashkëpunim. Numri i pjesëmarrjeve në aktivitete shkencore 8.


☑ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

